



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.61**

**25 maj**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9725 datë 7.5.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike .....	1635
Ligj nr.9726 datë 7.5.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e dytë shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike..	1638
Ligj nr.9727 datë 7.5.2007	Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rehabilitimit dhe të ndërtimit të rrugës Fier (Levan) – Tepelenë .....	1640
Ligj nr.9728 datë 10.5.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për projektin e transportit” .....	1664
Ligj nr.9729 datë 10.5.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e transportit” .....	1672
Ligj nr.9730 datë 10.5.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e administrimit dhe menaxhimit të tokës” .....	1676

**LIGJ**  
**Nr.9725, datë 7.5.2007**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHITESË TË  
PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5321, datë 21.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**PROTOKOLL SHITESË I PAKTIT NDËRKOMBËTAR**  
**PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE**

Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2200A (XXI) e datës 16 dhjetor 1966

Hyrë në fuqi më 23 mars 1976, në përputhje me nenin 9

Shtetet Palë në këtë Protokoll:

*duke marrë në konsideratë* se për arritjen e mëtejshme të qëllimeve të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (këtu e tutje e referuar si “Pakti”) dhe zbatimin e dispozitave të saj, do të ishte e përshtatshme t’i krijonte mundësinë Komitetit të të Drejtave të Njeriut të krijuar në pjesën IV të Paktit (këtu e tutje referuar si “Komiteti”) të merrte dhe shqyrtonte, siç parashikohet në këtë Protokoll, komunikimin nga individët që pretendojnë të jenë viktime të shkeljeve të ndonjë prej të drejtave të parashtruara në Pakt,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Një Shtet Palë në Pakt, i cili bëhet Palë në këtë Protokoll njeh kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet nga individët, subjekt i juridiksionit të saj, të cilët pretendojnë të jenë viktime të një shkeljeje nga ai Shtet Palë të ndonjë prej të drejtave të parashtruara në Pakt. Asnjë komunikim nuk merret nga Komiteti nëse ka lidhje me një Shtet Palë të Paktit, i cili nuk është Palë në këtë Protokoll.

## Neni 2

Subjekt i dispozitave të nenit 1, individët të cilët pretendojnë shkeljen e ndonjë prej të drejtave të tyre të përcaktuara në Pakt dhe që kanë konsumuar të gjitha zgjidhjet e brendshme në dispozicion, mund t'i paraqesin një komunikim me shkrim Komitetit për shqyrtim.

## Neni 3

Komiteti çmon si të papranueshëm çdo komunikim sipas këtij Protokollit që është anonim ose të cilin ai e çmon të jetë abuzim i të drejtës së paraqitjes së këtyre komunikimeve ose në mospajtim me dispozitat e Paktit.

## Neni 4

1. Subjekt i dispozitave të nenit 3, Komiteti sjell në vëmendjen e Shtetit Palë në këtë Protokoll çdo komunikim të dorëzuar atij sipas këtij Protokollit, që supozohet të shkelë ndonjë dispozitë të Paktit.

2. Brenda gjashtë muajsh, Shteti dërgues do t'i paraqesë Komitetit shpjegime ose deklarata me shkrim, duke shpjeguar çështjen dhe zgjidhjen, nëse ka, që mund të jetë përfutur nga ai Shtet.

## Neni 5

1. Komiteti shqyrton komunikimet e marra sipas këtij Protokollit nën dritën e gjithë informacionit me shkrim që i është vënë në dispozicion nga individit dhe nga Shteti Palë i interesuar.

2. Komiteti nuk shqyrton ndonjë komunikim nga një individ, për sa kohë që nuk ka vërtetuar se:

a) e njëjta çështje nuk po shqyrtohet sipas një procedure tjetër të hetimit ose marrëveshjeje ndërkombëtare;

b) individit ka konsumuar të gjitha zgjidhjet e brendshme në dispozicion. Ky nuk është rregull kur zbatimi i zgjidhjeve zgjatet në mënyrë të paarsyeshme.

3. Komiteti zhvillon takime të mbyllura kur shqyrton komunikimet sipas këtij Protokollit.

4. Komiteti i paraqet pikëpamjet e tij Shtetit Palë të interesuar dhe individit.

## Neni 6

Komiteti përfshin në raportin e tij vjetor sipas nenit 45 të Paktit një përmbledhje të aktiviteteve të tij sipas këtij Protokollit.

## Neni 7

Në pritje të arritjes së objektivave të Rezolutës 1514 (XV), të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e datës 14 dhjetor 1960 në lidhje me Deklaratën mbi Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë, dispozitat e këtij Protokollit nuk do të kufizojnë në asnjë mënyrë të drejtën e peticionit dhënë këtyre popujve nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe konventave e instrumenteve të tjera ndërkombëtare sipas Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të saj të specializuara.

## Neni 8

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet, i cili ka nënshkruar Paktin.

2. Ky Protokoll është objekt ratifikimi nga çdo shtet, i cili ka ratifikuar ose aderuar në Pakt. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Ky Protokoll është i hapur për aderim nga çdo shtet, i cili ka ratifikuar ose aderuar në këtë Pakt.

4. Aderimi realizohet me anë të depozitimit të një instrumenti aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet, të cilat kanë nënshkruar këtë Protokoll ose që kanë aderuar në të, në lidhje me depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi aderimi.

#### Neni 9

1. Pas hyrjes në fuqi të Paktit, ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë Protokoll ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit, ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

#### Neni 10

Dispozitat e këtij Protokoll do të shtrihen në të gjitha pjesët e shteteve federale, pa kufizime ose përjashtime.

#### Neni 11

1. Çdo Shtet Palë në këtë Protokoll mund të propozojë një amendim dhe ta depozitojë atë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm i komunikon çdo amendim të propozuar Shteteve Palë në këtë Protokoll me një kërkesë që ata e njoftojnë atë nëse e favorizojnë një konferencë të Shteteve Palë, për qëllim të shqyrtimit dhe votimit në lidhje me propozimin. Në rast se të paktën një e treta e Shteteve Palë favorizon këtë konferencë, Sekretari i Përgjithshëm mban një konferencë nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo amendim i miratuar nga një shumicë e Shteteve Palë të pranishme dhe votuese në konferencë i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për miratim.

2. Amendimet do të hyjnë në fuqi kur të jenë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe pranuar nga dy të tretat e Shteteve Palë në këtë Protokoll, në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese.

3. Kur amendimet hyjnë në fuqi, do të jenë detyruese për ato Shtete Palë që i kanë pranuar, Shtete të tjera Palë që kanë ende detyrime ligjore për dispozitat e këtij Protokoll dhe çdo amendim të mëparshëm, të cilin kanë pranuar.

#### Neni 12

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Denoncimi nuk cenon zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave të këtij Protokoll për çdo komunikim të paraqitur sipas nenit 2 para datës efektive të denoncimit.

#### Neni 13

Pavarësisht nga njoftimet e bëra sipas nenit 8 paragrafi 5 të këtij Protokoll, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të informojë të gjitha shtetet e referuara në nenin 48 paragrafi I të Paktit, në lidhje me detajet e mëposhtme:

a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 8;

- b) data e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll sipas nenit 9 dhe data e hyrjes në fuqi të çdo amendimi sipas nenit 11;
- c) denoncimet sipas nenit 12.

#### Neni 14

1. Ky Protokoll, tekstet e të cilit në gjuhën kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, do të depozitohet në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të transmetojë kopjet e vërtetuara të këtij Protokoll të gjitha shteteve të referuara në nenin 48 të Paktit.

### LIGJ

Nr.9726, datë 7.5.2007

## **PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E DYTË SHITESË TË PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

#### Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin e dytë shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5322, datë 21.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

## **PROTOKOLLI I DYTË SHITESË I PAKTIT NDËRKOMBËTAR MBI TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE, MBI HEQJEN E DËNIMIT ME VDEKJE**

Miratur dhe shpallur nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr.44/128 e datës 15 dhjetor 1989

Shtetet Palë në këtë Protokoll,

*duke besuar* se heqja e dënimit me vdekje kontribuon në zhvillimin e dinjitetit njerëzor dhe zhvillimit progresiv të të drejtave të njeriut;

*duke risjellë* në mend nenin 3 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, të miratur më 10 dhjetor 1948 dhe nenin 6 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të miratur më 16 dhjetor 1966;

*duke vënë re* se neni 6 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike i referohet heqjes së dënimit me vdekje që sugjeron fuqimisht se është i pëlqyeshëm;

*të bindur* se të gjitha masat e heqjes së dënimit me vdekje duhet të konsiderohen progresive në gëzimin e së drejtës për të jetuar;

*me dëshirën* për të ndërmarrë një angazhim ndërkombëtar për heqjen e dënimit me vdekje, kane rënë dakord si më poshtë vijon:

#### Neni 1

1. Askush brenda juridiksionit të një Shteti Palë në këtë Protokoll nuk ekzekutohet.
2. Çdo Shtet Palë merr të gjitha masat e nevojshme për heqjen e dënimit me vdekje brenda juridiksionit të tij.

#### Neni 2

1. Asnjë rezervë nuk lejohet në këtë Protokoll, përveç një rezerve të bërë në kohën e ratifikimit ose aderimit që parashikon zbatimin e dënimit me vdekje në kohën e luftës, sipas një dënimi për krimin më të rëndë të një natyre ushtarake të kryer gjatë periudhës së luftës.
2. Shteti Palë që bën këtë rezervë, në kohën e ratifikimit ose aderimit, i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, dispozitat përkatëse të legjislacionit të saj kombëtar të zbatueshëm gjatë periudhës së luftës.
3. Shteti Palë që ka bërë këtë rezervë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në lidhje me çdo fillim ose mbarim të gjendjes së luftës, të zbatueshëm në territorin e tij.

#### Neni 3

Shtetet Palë në këtë Protokoll përfshijnë në raportet që ata i paraqesin Komitetit të të Drejtave të Njeriut, në përputhje me nenin 40 të Paktit, informacion në lidhje me masat që ata kanë miratuar për t'i dhënë fuqi ligjore këtij Protokollit.

#### Neni 4

Përsa i përket Shteteve Pale të Paktit që kanë bërë një deklaratë sipas nenit 41, kompetenca e Komitetit të të Drejtave të Njeriut për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet kur një Shtet Palë pretendon se Shteti tjetër Palë nuk po përmbush detyrimet e tij, shtrihet për dispozitat e këtij Protokollit nëse Shteti Palë i interesuar nuk ka bërë një deklaratë për të kundërtën në momentin e ratifikimit ose aderimit.

#### Neni 5

Përsa i përket Shteteve Palë në Protokollin e Parë Shtesë të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të miratuar më 16 dhjetor 1966, kompetenca e Komitetit të të Drejtave të Njeriut për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet nga individë, objekt i juridiksionit të saj, shtrihet për dispozitat e këtij Protokollit, nëse Shteti Palë i interesuar nuk ka bërë një deklaratë për të kundërtën në momentin e ratifikimit ose aderimit.

#### Neni 6

1. Dispozitat e këtij Protokollit zbatohen si dispozita shtesë të Paktit.
2. Pa cenuar mundësinë e një rezerve sipas nenit 2 të këtij Protokollit, e drejta e garantuar në nenin 1 paragrafi 1 të këtij Protokollit, nuk është objekt i ndonjë devijimi sipas nenit 4 të Paktit.

#### Neni 7

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet që ka nënshkruar Paktin.
2. Ky Protokoll është objekt ratifikimi nga çdo shtet që ka ratifikuar Paktin ose aderuar në të. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Ky Protokoll është i hapur për aderim nga çdo shtet që ka ratifikuar Paktin ose ka aderuar në të.

4. Aderimi bëhet me anë të depozitimit të një instrumenti aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose aderuar në të, në lidhje me depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi.

#### Neni 8

1. Ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë Protokoll ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit, ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

#### Neni 9

Dispozitat e këtij Protokoll shtrihen për të gjitha pjesët e shteteve federale, pa kufizime ose përjashtime.

#### Neni 10

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet e referuara në nenin 48 paragrafi 1 të Paktit, në lidhje me detajet e mëposhtme:

- a) Rezervat, komunikimet dhe njoftimet sipas nenit 2 të këtij Protokoll;
- b) Deklaratat e bëra sipas neneve 4 ose 5 të këtij Protokoll;
- c) Nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 7 të këtij Protokoll;
- d) Data e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll sipas nenit 8 të tij.

#### Neni 11

1. Ky Protokoll, tekstet e të cilit në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëloj autentike, depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Kombeve të Bashkuara i transmeton kopjet e vërtetuara të këtij Protokoll të gjitha shteteve të referuara në nenin 48 të Paktit.

### LIGJ

**Nr.9727, datë 7.5.2007**

## **PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT DHE TË NDËRTIMIT TË RRUGËS FIER (LEVAN) – TEPELENË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pikat 1 e 2 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rehabilitimit dhe të ndërtimit të rrugës Fier (Levan) – Tepelenë.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5323, datë 21.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

FIN<sup>0</sup> (AL)  
SERAPIS N<sup>0</sup> 2004-0330

**PROJEKTI I RRUGËS FIER-TEPELENË/A  
KONTRATË FINANCIARE  
MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE  
TË INVESTIMEVE**

Kjo kontratë është nënshkruar midis:

Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financës, si dhe nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, që në këtë dokument do të quhet: “Huamarrës”, dhe

Bankës Europiane të Investimeve, me seli në: 100, Bulevard Konrad Adenauer, Luxembourg, përfaqësuar nga /, / dhe /, / që në këtë dokument do të quhet: “Banka”,

Në të cilën:

1. Huamarrësi ka shpallur se do të ndërmarrë një projekt (që në këtë dokument do të quhet “Projekti”) për të realizuar një rrugë transporti me një kalim, 70 km të gjatë, midis Fierit dhe Tepelenës, si pjesë e korridorit shqiptar Veri-Jug. Projekti konsiston në një segment të ri prej 37 km, si dhe në rehabilitimin e rrugës ekzistuese (me disa përmirësime përgjatë saj) për segmentin e mbetur prej 33 km, përcaktuar më në detaje në përshkrimin teknik (që në këtë dokument do të quhet “Përshkrimi teknik”), paraqitur në aneksin A.1 të këtij dokumenti;

2. Kostoja totale e projektit, siç është përlllogaritur nga Banka, është 101,000,000 euro (njëqind e një milionë euro);

3. Huamarrësi ka përcaktuar se synon të financojë projektin si më poshtë:

Zërat e financimit	milion EUR
Fondet e vetë Huamarrësit	13.3
Kredi nga Banka	50
Hua nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (që në këtë dokument do të quhet "BERZH" dhe huaja "Hua e BERZH-it")	35
<b>TOTALI</b>	<b>101</b>

4. Me qëllim që të përmbushet plani financiar i paraqitur në pikën (3), Huamarrësi ka kërkuar nga Banka një kredi me vlerë 50,000,000 euro (pesëdhjetë milionë euro);

5. Në përgjigje të kërkesës së Huamarrësit, duke parë se financimi i projektit përputhet me qëllimin e funksionit të tij, si dhe duke u mbështetur në përcaktimet dhe faktet e paraqitura në deklaratimet e bëra, Banka ka vullnetin e mirë të vërë në dispozicion të Huamarrësit kredinë me vlerë 50,000,000 euro (pesëdhjetë milionë euro);

6. Statuti i Bankës lejon që Banka të garantojë përdorimin e fondeve në mënyrë sa më racionale në interes të Bashkimit European; si dhe lidhur me këtë, kushtet dhe termat e operacioneve huadhënësve të Bankës duhet të jenë në përputhje me politikat e përshtatshme të Bashkimit European;



7. Ndaj, në këtë aspekt Banka ka vullnetin e mirë të vërë në dispozicion kredinë e parë prej 35,000,000 euro (tridhjetë e pesë milionë euro) nën këtë kontratë financiare (që në këtë dokument do të quhet “Kontrata”);

8. Interpretimi:

i) Referencat e paraqitura këtu mbi nenet, pjesët, listat dhe anekset, janë referencat mbi nenet, pjesët, listat dhe anekset respektive të kësaj kontrate;

ii) Referenca mbi një nen është referencë ndaj të tërë nenit, me përjashtim të rasteve të specifikuara; dhe

iii) Termat e mëposhtëm të renditur në pjesët në vijim kanë kuptimet respektive të dhëna për to në pjesët dhe nenet e specifikuara në këtë dokument;

9. Përkufizime:

Terma të përcaktuar në kontratë	Neni apo pjesa
Afati i miratimit	4.02C
Kontratë	Pjesa (7)
Kredi	1.01
Njoftim pagese	1.02C
Kërkesë për pagesë	1.02B
Përqindja rishpërndarë BEI	4.02
Mjedisi	6.05(v)
Përqindje fikse	3.01
Transhi i përqindjes fikse	1.02B
Hua	2.01
Ditë pune Luksemburgu	1.02C
Datë maturimi	4.01(iii)
Transhi i njoftuar	1.06B
Data e pagesës	5.01
Shuma e parapaguar	4.02A
Data e parapagesës	4.02A
Njoftimi për parapagim	4.02A
Projekti pjesa (1)	
Dita e parë e tremujorit	3.01B
Ditë e përshtatshme biznesi	5.01
Përqindja e përshtatshme e interbankës	1.02B
Data e planifikuar e disbursimit	1.02C
Përshkrimi teknik	Recital (1)
Periudha e huasë	4.03A(2)
Transhi	1.02A

Terma të paraqitur në lista

EURIBOR	Lista B
Datë e rivendosur	Lista B

Si rrjedhojë në këtë dokument është rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1  
**Kredia dhe disbursimi**

1.02 Kredia

Përmes kësaj kontrate, Banka vendos në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi (që në këtë dokument do të quhet “Kredia”) me një shumë prej 35,000,000 euro (tridhjetë e

pesë milionë euro), me të vetmin qëllim, atë të financimit të projektit.

### 1.03 Procedura e disbursimit

#### 1.03 A Transhet

Banka do të disbursojë kredinë deri në 15 transhe. Shuma e secilit prej transheve, në rast se nuk përbën një bilanc të hapur kredie, do të jetë një minimum prej 2,000,000 euro (dy milionë euro). Një transh i kërkuar nga Huamarrësi, në përputhje me nenin 1.02B në këtë dokument, do të quhet “Transh”.

#### 1.03 B Kërkesa për disbursim

Herë pas here deri më 30 nëntor 2009, Huamarrësi mund të paraqesë përpara Bankës një kërkesë me shkrim (një “Kërkesë për disbursim”), kryesisht në formën e paraqitur në listën C, mbi disbursimin e një transhi. Kërkesa për disbursim duhet të specifikojë:

i) Shumën e transhit;

ii) Datën e parapëlqyer për disbursim, që duhet të jetë një ditë e përshtatshme biznesi (siç përcaktohet në nenin 5.01), duke marrë në konsideratë se Banka mund të disbursojë transhin deri në një periudhë katër muaj kalendarikë nga data e kërkesës për disbursim;

iii) Nëse transhi do të mbartë një shkallë fikse interesi (p.sh. një “Transh me interes-fiks”), përcaktuar në përputhje me parashikimet respektive të nenit 3.01 apo një interes të nxjerrë sipas shpërndarjes variabël (p.sh. një “Transh me interes të nxjerrë nga shpërndarje variabël” apo “Transh VSFR”); atëherë pagesa e preferuar e interesit për transhin në mënyrë periodike, përzgjidhet në përputhje me nenin 3.01;

iv) Datat e parapëlqyera të pagesës zgjidhen në përputhje me nenin 5.01;

v) Kushtet e preferuara për ripagesën e principalit, zgjidhen në përputhje me nenin 4.01.

Në rastin e një transhi me interes fiks, Huamarrësi, me zgjedhjen e tij, mundet që në kërkesën për disbursim të specifikojë gjithashtu edhe përqindjen e interesit përcaktuar nga Banka, duke mos pasur detyrimin e aplikimit në transh gjatë kohështrirjes së tij.

Për qëllime të kësaj kontrate, “Përqindje relevante e interbankës” nënkupton EURIBOR.

Në përputhje me paragrafin e dytë nga fundi të nenit 1.02C, çdo kërkesë për disbursim është e pakthyeshme.

#### 1.03 C Njoftimi për disbursim

Dhjetë apo 15 ditë para datës së disbursimit të një transhi, nëse kërkesa për disbursim është në përputhje me nenin 1.02B dhe nëse në rastin e transhit të parë janë përmbushur kushtet e nenit 1.04, atëherë Banka i dorëzon Huamarrësit një njoftim (që në këtë dokument do të quhet “Njoftimi për disbursim”), i cili do të specifikojë:

i) Shumën e transhit;

ii) Bazat e përqindjes së interesit;

iii) Datat e aplikueshme të pagesave;

iv) Kushtet e ripagimit të principalit, si dhe periodicitetin e pagesës së interesit;

v) Datën në të cilën është planifikuar të disbursohet transhi (që në këtë dokument do të quhet “Lista e datës së disbursimit”), ku disbursimi në çdo rast është subjekt i kushteve të përcaktuara në nenin 1.05.

Nëse një apo më shumë elemente të specifikuara në njoftimin për disbursim nuk përputhen me elementin korrespondues, në kërkesën për disbursim, brenda tre ditëve pune Luksemburgu, Huamarrësi në vijim të marrjes së njoftimit për disbursim, pa pasur detyrime, anulon kërkesën për disbursim, duke njoftuar Bankën dhe mbi këtë bazë shfuqizohen si kërkesa për disbursim, ashtu dhe njoftimi për disbursim.

Për qëllime të kësaj kontrate, përgjithësisht, “Ditë pune Luksemburgu” do të nënkuptojë një ditë në të cilën bankat tregtare janë të hapura për biznes në Luksemburg.

#### 1.03 D Llogaria për disbursim

Disbursimi i një transhi kryhet në llogarinë bankare, pasi Huamarrësi të ketë njoftuar me shkrim Bankën jo më pak se 15 ditë para datës së planifikuar për disbursim.

#### 1.04 Monedha e disbursimit

Banka do të disbursojë secilin transh në euro.

#### 1.05 Kushtet për pranimin e kërkesës së parë për disbursim

Pranimi i kërkesës së parë për disbursim është subjekt i tërheqjes nga ana e Bankës të dokumenteve apo evidencave të mëposhtme, në formë dhe përmbajtje të pranueshme prej saj:

i) Një opinion ligjor i lëshuar nga Ministri i Drejtësisë së Huamarrësit, paraqitur në gjuhën angleze ose përkthyer në anglisht, ku konfirmohet:

a) se kjo kontratë përputhet me qëllimin e marrëveshjes së strukturës, nënshkruar më 5 shkurt 1998 midis Huamarrësit dhe Bankës, ku zbatimi i kësaj kontrate autorizohet në kohën e duhur nga një vendim i Këshillit të Ministrave të Huamarrësit, se nënshkruarit e kësaj kontrate marrin në afat kompetencën për nënshkrimin e saj në emër të Huamarrësit, se Parlamenti i Huamarrësit e ratifikon këtë kontratë në afat, se kushtet e kësaj kontrate janë fuqiplota, në efekt, të vlefshme, detyruese dhe në fuqi në Shqipëri, në përputhje me kushtet e saj; dhe

b) se të gjitha miratimet e nevojshme mbi kontrollin e shkëmbimeve janë garantuar, me qëllim që Huamarrësi të lejohet të marrë shumat e disbursuara, për të ripaguar huanë dhe për të paguar interesat, si dhe të gjitha shumat e tjera nën këtë kontratë; si dhe këto miratime çojnë në hapjen dhe mbajtjen e llogarive, të cilat Huamarrësi do të adresojë Bankën për disbursimin e kredisë;

ii) marrja e një të drejte për hua nga ana e Huamarrësit për zbatimin e projektit, si dhe transferime të përshtatshme të kontraktori(ët);

iii) kompletimi i Planit Kombëtar të Transporteve, në përputhje me aprovimin bërë nga Ministri i Transporteve dhe prezantimi i tij për aprovim në Këshillin e Ministrave të Huamarrësit;

iv) e drejta e Huamarrësit për hua nga BERZH-i, e drejta e Huamarrësit për të marrë fonde grant nga Bashkimi Europian për konsulentin e supervizionit, si dhe prania e fondeve të mjaftueshme nga burime të tjera për financimin e konsulentit të supervizionit;

v) marrëveshja e Huamarrësit, BERZH-it dhe Bankës lidhur me Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

Nëse kushtet e lartpërmendura nuk përmbushen në mënyrë të kënaqshme, deri në afatin më të fundit <15 janar 2006>, me përjashtim të rasteve ku do të bihet dakord midis Bankës dhe Huamarrësit, atëherë kredia do të anulohet.

#### 1.06 Kushtet për disbursim

##### 1.06 A Transhi i parë

Pa cenuar nenin 1.04 më lart, disbursimi i transhit të parë sipas nenit 1.02 është subjekt i marrjes nga Banka të dokumenteve apo evidencave të mëposhtme, të cilat duhet të jenë të pranueshme si në formë, ashtu dhe në përmbajtje. Këto dokumente duhen marrë nga Banka më apo përpara datës që është shtatë ditë përpara ditëve të biznesit në Luksemburg nga data e planifikuar e disbursimit. Dokumentet apo evidencat përfshijnë:

i) krijimi i një njësie për zbatimin e projektit "PIU", që do të koordinojë, menaxhojë, monitorojë dhe vlerësojë të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, duke përfshirë dhe prokurimin e mallrave, punimet dhe shërbimet civile, nën termat e referencës që duhet të dakordësohen me Bankën;

ii) ekzekutimin nga ana e Huamarrësit të një kontrate për supervizionin e punimeve, me qëllim që të monitorohen të gjitha aspektet e zbatimit të punëve civile të projektit; dhe

iii) deklarin nga Ministria e Mjedisit të Huamarrësit mbi garancinë lidhur me konservimin e natyrës. Kjo deklaratë duhet të dorëzohet me dorëzimin pranë Bankës të një studimi mbi ambientin, ku vlerësohet ndikimi potencial i projektit mbi habitatin në zonën e lumit Vjosë.

##### 1.06 B Secili nga transhet

Disbursimi i secilit nga transhet, duke përfshirë, pa kundërshtuar nenin 1.05A, transhin e parë, do të jenë subjekt i përmbushjes së kushteve të mëposhtme në përputhje me kërkesat e Bankës,

gjë që do të thotë se në apo para datës së kërkesës për disbursimin relevant, Huamarrësi do të ketë tërhequr:

i) evidencën e autoritetit të personit apo personave të autorizuar për të nënshkruar kërkesën për disbursim në emër të Huamarrësit, si dhe vërtetimin e firmës origjinale të personit apo personave;

ii) dokumentet që evidentojnë se Huamarrësi është në përputhje të plotë me nenin 6.06 dhe 6.07.

1.06 C Nëse kërkesa për disbursim lidhur me cilindo prej transheve bëhet para se Banka të ketë në dorë evidenca që në mënyrë të kënaqshme demonstrojnë përmbushjen e të gjitha kushteve të specifikuara në nenin 1.05, atëherë kërkesa për disbursim do të gjykohet deri në përmbushjen e këtyre kushteve.

1.07 Shtyrje e afatit të disbursimit

1.07 A Baza për shtyrjen e afatit

Banka, me kërkesë nga Huamarrësi, mund ta shtyjë afatin e disbursimit të çdo transhi si të tërë apo pjesë të tij, deri në një datë të specifikuar nga Huamarrësi, e cila duhet të jetë një datë jo më vonë se gjashtë muaj nga data e planifikuar për disbursim. Në një rast të tillë, Huamarrësi do të paguajë dëmshpërblim për shtyrje afati, mbështetur në nenin 1.06B më poshtë. Çdo kërkesë për shtyrje afati do të ketë efekt lidhur me një transh të caktuar vetëm nëse bëhet së paku 7 ditë biznesi Luksemburgu para datës së planifikuar për disbursim.

Nëse ndonjë prej kushteve të parashtruara në nenin 1.05 nuk përmbushet në datën e caktuar, dhe në datën e planifikuar për disbursim, atëherë disbursimi do të shtyhet për një datë që do të bihet dakord midis Bankës dhe Huamarrësit, datë e cila nuk duhet të jetë brenda shtatë ditëve biznesi Luksemburgu, me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet e disbursimit.

1.07 B Dëmshpërblimi për shtyrje afati

Nëse disbursimi i cilitdo transhi të shpallur (siç përcaktohet më poshtë në nenin 1.06B) shtyhet me kërkesë të Huamarrësit apo për arsye të mospërmbushjes së kushteve të disbursimit, atëherë Huamarrësi, me kërkesë të Bankës, do të paguajë një dëmshpërblim për shumën mbi të cilën është kërkuar shtyrja e afatit. Një dëmshpërblim i tillë do të ndodhë nga data e planifikuar për disbursim deri në datën aktuale të disbursimit, apo sipas rastit deri në datën e anulimit të transhit me një interes të barabartë me  $R1$  minus  $R2$ , ku:

“ $R1$ ” është përqindja e interesit që do të ishte aplikuar kohë mbas kohe në përputhje me nenin 3.01 dhe njoftimin për disbursimin relevant, nëse transhi do të ishte disbursuar në datën e planifikuar për disbursim; dhe

“ $R2$ ” është përqindja relevante e interbank minus 0.125% (12.5 pika bazë); duke pasur parasysh se, me qëllim përcaktimit e përqindjes relevante të interbank në përputhje me nenin 1.06, periudhat relevante të dhëna në listën B do të jenë periudha një muaj më pas datës së planifikuar për disbursim.

Gjithashtu, dëmshpërblimi kryhet:

i) nëse shtyrja kalon periudhën kohore prej një muaji, atëherë do të shtohet në fund të çdo muaji;

ii) do të llogaritet me ditën që përfshin marrëveshjen e aplikueshme për  $R1$ ;

iii) kur  $R2$  tejkalon  $R1$ , do të fiksohet në nivelin zero, dhe

iv) do të jetë e pagueshme në përputhje me nenin 1.08.

Në këtë kontratë, një “Transh i njoftuar” nënkupton transhin në lidhje me të cilin Banka ka lëshuar njoftimin për disbursim.

1.07 C Anulimi i disbursimit të shtyrë me gjashtë muaj

Banka, pasi ka njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë një disbursim që është shtyrë sipas nenit 1.06A për një periudhë kohore në total më të gjatë se gjashtë muaj. Shuma e anuluar do të mbetet në dispozicion për disbursim sipas nenit 1.02.

1.08 Anulimi dhe pezullimi

1.08 A E drejta e Huamarrësit për anulim

Huamarrësi, në çdo kohë, me anë të njoftimit drejtuar Bankës, mundet të anulojë, me efekt të menjëhershëm, pjesë apo të tërë porcionin e padisbursuar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk do të ketë efekt në rastin e transheve të njoftuara, data e planifikuar për disbursimin e të cilave bie brenda shtatë ditëve biznesi Luksemburgu që pasojnë ditën e njoftimit.

#### 1.08 B Të drejtat e Bankës për të pezulluar dhe anuluar

Banka, përmes njoftimit të Huamarrësit, mundet, në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm, të pezullojë apo të anulojë porcione të padisbursuara të kredisë si pjesë apo si një e tërë:

- i) në çfarëdo rasti parashtruar në nenin 4.03A apo nenin 10.01;
- ii) në rrethana të jashtëzakonshme, që ndikojnë mbi aksesin e Bankës në tregun e kapitaleve, veç rasteve të një transhi të njoftuar;
- iii) nëse me një veprim të logjikshëm, nuk kënaqet me mospërputhshmërinë e garancive apo sipërmarrjeve të dhëna nga Huamarrësi sipas neneve 6.08 dhe 8.04.

Çdo pezullim do të vazhdojë për aq kohë sa Banka të mbyllë pezullimin apo të anulojë sasinë e pezulluar.

#### 1.08 Dëmshtëpërblimi për pezullime dhe anulimi i një transhi

##### 1.08 (1) Pezullimi

Nëse Banka pezullon një transh të njoftuar mbi një rast të parashtruar në nenin 4.03A dhe /apo 10.01, por jo në ndonjë rast tjetër, atëherë Huamarrësi duhet të dëmshtëpërblejë Bankën sipas nenit 1.06B.

##### 1.08 C(2) Anulimi

Nëse Huamarrësi anulon një transh të njoftuar, atëherë do të dëmshtëpërblejë Bankën sipas nenit 4.02B. Nëse Huamarrësi anulon cilëndo pjesë të kredisë, përveç transhit të njoftuar, nuk paguhet asnjë dëmshtëpërblim.

Nëse Banka anulon një disbursim sipas nenit 1.06C, Huamarrësi do të dëmshtëpërblejë Bankën sipas nenit 4.02B. Nëse Banka anulon një transh të njoftuar mbi bazën e ndonjë rasti të përmendur në nenin 10.01, atëherë Huamarrësi do të dëmshtëpërblejë Bankën sipas nenit 10.02. Me përjashtim të këtyre rasteve, asnjë dëmshtëpërblim nuk paguhet mbi anulimin nga ana e Bankës.

Dëmshtëpërblimi llogaritet mbi bazën e shumës së anuluar të menduar për t'u disbursuar dhe ripaguar në datën e planifikuar për disbursim apo në nivelin e disbursimit të transhit që momentalisht është shtyrë apo pezulluar, në ditën e njoftimit për anulim.

##### 1.08 D Anulimi pas skadimit të kredisë

Pa paragjykuar parashikimet e dhëna në nenin 1.04, në çdo kohë pas afatit që ka Huamarrësi për të paraqitur një kërkesë disbursimi sipas nenit 1.02B, Banka, me anë të njoftimit që i paraqet Huamarrësit dhe pa detyrime që mund të ngrihen nga të dy Palët, mundet të anulojë çdo pjesë të kredisë me përjashtim të një transhi të njoftuar.

##### 1.09 Shumat për t'u paguar sipas nenit 1

Shumat për t'u paguar, sipas neneve 1.06 dhe 1.07, do të jenë të pagueshme në euro brenda shtatë ditëve nga data e marrjes së kërkesës bankare prej Huamarrësit, apo brenda çfarëdo periudhe të mëvonshme të specifikuar në njoftimin e kërkesës së Bankës.

## Neni 2

### Huaja

#### 1.10 Sasia e huasë

Huaja nën kredinë (që në këtë dokument do të quhet "Huaja") do të përbëhet nga total i sasive të disbursuara nga Banka në euro, siç njoftohet nga Banka sipas rastit të disbursimit të çdo transhi.

#### 1.11 Monedha e shlyerjeve

Çdo shlyerje e një transhi, sipas nenit 4 apo sipas rastit nenit 10, do të kryhet në euro.

#### 1.12 Monedha e interesit dhe pagesa të tjera

Interesat dhe pagesat e tjera të pagueshme nga Huamarrësi sipas nenit 3, 4 dhe kur është e

zbatueshme sipas nenit 10, do të llogariten dhe paguhen për çdo transh në euro.

Çdo pagesë tjetër do të kryhet në monedhën e specifikuar nga Banka, duke pasur parasysh se monedha në të cilën kryhen shpenzimet do të shërbejë për rimbursim me anë të kësaj pagese.

#### 1.13 Konfirmimi bankar

Pas disbursimit të një transhi, Banka do të shpërndajë tek Huamarrësi një përmbledhëse, ku tregohet data e disbursimit, shuma, kushtet e shlyerjes, si dhe përqindjet e interesit mbi dhe për atë transh. Një konfirmim i tillë do të përfshijë dhe tabelën e amortizimit.

### Neni 2

#### Interesat

##### 1.14 Përqindjet e interesave

###### 1.14A Transhe me përqindje fikse

Huamarrësi do të paguajë interesa mbi balancën e mbetur për çdo transh, me përqindje fikse në periudhe gjashtëmujore apo vjetore mbi vonesat nga data e pagesës relevante, siç është specifikuar në njoftimin për disbursim, duke nisur nga data e parë e një pagese të tillë që ndjek ditën e disbursimit të transhit.

Interesat do të kalkuloohen mbi bazën e nenit 5.02(ii) në përqindje fikse.

Në këtë kontratë, “Përqindje fikse” nënkupton një përqindje interesi vjetore, e përcaktuar nga Banka në përputhje me principet e zbatuara herë pas here, përcaktuar nga instrumentet drejtuese të Bankës për huatë e realizuara me një përqindje interesi fikse, të përcaktuara në monedhën e transhit, duke dhënë kushte të barabarta për ripagesat e kapitalit dhe pagesën e interesit.

###### 1.14 B Transhet VSFR

Huamarrësi do të paguajë interesa mbi shumën e pashlyer për çdo transh VSFR të VSFR (siç përcaktohet më poshtë), çdo tremujor, gjashtëmujor apo çdo vit për vonesat nga çdo ditë pagese relevante, siç është specifikuar në njoftimin për disbursim, subjekt i një tavani të shkallës së interbankës relevante plus 0.55% (pesëdhjetë e pesë pikë bazë). Nëse transhi disbursohet në një datë që nuk është dita e parë e tremujorit (apo nëse dita e parë e tremujorit nuk bie në një ditë relevante biznesi, në ditën e parë pasuese që është një ditë relevante biznesi), interesi për periudhën nga dita e disbursimit deri në ditën e parë të tremujorit, do të jetë i pagueshëm në një përqindje interbanke relevante. Banka do të njoftojë VSFR tek Huamarrësi brenda 10 ditëve, duke ndjekur fillimin e çdo periudhe referimi VSFR mbi të cilën ajo zbatohet.

Interesi duhet të llogaritet në përputhje me periudhën e referencës së secilës VSFR, mbi bazën e nenit 5.02(i).

Në këtë kontratë:

“Fillim i tremujorit” nënkupton çdo 15 mars, 15 qershor, 15 shtator dhe 15 dhjetor.

“VSFR” nënkupton shpërndarjen variabël të përqindjes bazë të interesit, që me fjalë të tjera është një përqindje interesi vjetore e përcaktuar nga Banka për çdo periudhë reference VSFR në përputhje me principet e zbatueshme herë pas here të përcaktuara nga instrumentet drejtuese të Bankës për huatë e realizuara me përqindje interesi dysheme, dhe jo të përcaktuar nga interesat e përqindjes së interbankës relevante.

“Periudha e referencës VSFR” nënkupton çdo periudhë nga dita e fillimit të tremujorit në ditën e fillimit të tremujorit pasues (nëse kjo ditë është ose jo ditë pagese).

##### 1.15 Interesat mbi shumat e vonuara

Pa paragjykuar nenin 10 dhe duke përjashtuar nenin 3.01, interesi do të aplikohet mbi çdo shumë të pashlyer të pagueshme sipas kushteve të kësaj kontrate nga data e afatit të pagesës deri në datën e pagesës me një përqindje vjetore të barabartë me përqindjen e interbankës relevante plus 2% (mbi bazën e dyqind pikëve) dhe do të jetë e pagueshme në përputhje me kërkesën e Bankës. Për të përcaktuar përqindjen e interbankës relevante në përputhje me nenin 3.02, periudhat relevante brenda parametrave të listës B do të jenë periudhat pasuese me një muaj duke filluar nga data e afatit për të paguar.

Megjithatë, interesi i një transhi me shkallë fikse do të ngarkohet me përqindjen vjetore, që është shuma e përqindjeve relevante të përcaktuara në nenin 3.01 plus 0.25% (njëzet e pesë pikë bazë), nëse kjo përqindje vjetore për çfarëdo arsyeje tejkalon përqindjen e specifikuar në paragrafin më lart.

Nëse shuma e papaguar është në një monedhë të ndryshme nga monedha e huasë, atëherë do të aplikohet përqindja e mëposhtme vjetore, që do të thotë përqindja e Bankës relevante për transaksione në atë monedhë plus 2% (dyqind pikë bazë), e llogaritur në përputhje me praktikën e tregut.

## Neni 2 **Ripagesat**

### 1.16 Ripagesat normale

Huamarrësi duhet të ripaguajë huanë mbi bazën e tabelës së amortizimit të bashkëngjitur si lista D në këtë dokument.

Data e fundit e ripagesës së një transhi të specifikuar në përputhje me nenin 4.01(iii) në këtë dokument do të quhet “Dita e maturimit”.

### 1.17 Parapagesa vullnetare

#### 1.17 A Opsioni i parapagesës

Subjekt i neneve 4.02B dhe 4.04, Huamarrësi mund të parapaguajë pjesë apo të tërë transhin, së bashku me interesin e grumbulluar, duke paraqitur një njoftim me shkrim një muaj në avancë (që do të quhet “Njoftimi për parapagim”), duke specifikuar këtu shumën që duhet parapaguar (Shuma për parapagim), si dhe datën në të cilën Huamarrësi propozon të bëjë efektive parapagesën (Data e parapagesës), datë e cila duhet të jetë një datë pagese për këtë transh.

#### 1.17 B Sigurimi i parapagesës

##### Transhet me përqindje fikse

Në përputhje me çdo shumë për parapagim të një transhi me përqindje fikse, Huamarrësi duhet t’i paguajë Bankës në datën e parapagesës një sigurim të barabartë me vlerën prezente (në ditën e parapagesës) për shtesa, nëse ka të tilla, për:

i) interesat që do të rrjedhin mbi shumën e parapaguar gjatë periudhës prej datës së parapagimit deri në datën e maturimit, nëse këto nuk janë parapaguar

mbi

ii) interesin që do të grumbullohet gjatë kësaj periudhe, nëse ky është llogaritur sipas përqindjes së rishpërndarjes së BEI-t (siç përcaktohet më poshtë) në më pak se 15 pikë bazë.

Vlera prezente e paraqitur do të llogaritet me një interes zbritës të barabartë me përqindjen e rishpërndarjes së BEI-t të aplikuar mbi çdo datë relevante pagese.

Në këtë kontratë, “Shkalla e rishpërndarjes BEI” nënkupton përqindjen fikse në fuqi një muaj para datës së parapagesës dhe që ka të njëjtat kushte për pagesën e interesit, si dhe të njëjtin profil ripagese për datën e maturimit.

#### 1.17 B (2) Transhi VSFR

Huamarrësi mund të ripaguajë një transh VSFR pa asnjë dëmshpërblim lidhur me një datë relevante pagese.

#### 1.17 C Mekanizmat e parapagesës

Banka do të njoftojë Huamarrësin, jo më vonë se 15 ditë para datës së parapagesës, lidhur me shumën për parapagesë, përqindjen e interesit, si dhe dëmshpërblime të pagueshme sipas nenit 4.02B apo sipas rastit, të njoftojë se nuk ka dëmshpërblime të paguara.

Jo më vonë se afati i pranimit (siç përcaktohet më poshtë), Huamarrësi duhet të njoftojë Bankën lidhur me:

i) nëse është konfirmuar njoftimi për parapagesë mbi termat e specifikuar nga Banka; ose

ii) nëse njoftimi për parapagesë është tërhequr.

Nëse Huamarrësi jep konfirmimin sipas pikës (i), kjo do të ndikojë mbi parapagesën. Nëse Huamarrësi tërheq njoftimin për parapagim apo nuk realizon konfirmimin në afatin e duhur, kjo nuk

do të ndikojë mbi parapagesën. Veç asaj që u përmend më lart, njoftimi për parapagim do të jetë detyrues dhe i pakthyeshëm.

Huamarrësi duhet ta shoqërojë parapagesën me pagesën e përqindjes së grumbulluar të interesit dhe detyrimeve, nëse ka të tilla, lidhur me shumën e parapaguar.

Për qëllime të nenit 4.02C, “Afati i pranimit” për një njoftim është: (a) ora 16:00 me kohën e Luksemburgut në ditën e paraqitjes, nëse njoftimi është dhënë në orën 14:00 të një dite biznesi në Luksemburg; apo (a) ora 11:00 e ditës pasardhëse që është një ditë biznesi në Luksemburg, nëse njoftimi është dhënë pas orës 14:00 me orën e Luksemburgut të çfarëdo dite, apo është dhënë në një ditë që nuk është ditë biznesi në Luksemburg.

1.18 Parapagesa e detyrueshme

1.18 A Baza e parapagesës

1.18 A (1) Reduktimi i kostos së projektit

Nëse kostoja totale e projektit duhet të reduktohet nga shifra e dhënë në pjesën (2) në një nivel në të cilin shuma e kredisë kalon 50% të një kostoje të tillë, Banka, në proporcion me reduktimin e menjëhershëm, duke njoftuar Huamarrësin, mundet të anulojë kredinë apo të kërkojë parapagesën e huasë.

1.18 A (2) *Pari passu* për ripagesën e kështit tjetër

Nëse Huamarrësi në mënyrë vullnetare parapaguan një pjesë të apo të tërë sasinë e ndonjë huaje tjetër, apo çfarëdo detyrimi apo kredie financiare, dhënë atij për një kohë më shumë se pesëvjeçare (që do të quhet “Këst huaje”), që në ndryshim nga lëvizjet e një huaje me këst së paku sa kësti në fuqi i huasë së parapaguar, Banka mundet që, duke njoftuar Huamarrësin, të anulojë kredinë apo të kërkojë parapagesën e huasë në atë proporcion sa shuma e ripaguar e kështit të huasë mbart në shumën e akumuluar të papaguar të të gjitha kësteve të huave.

Banka duhet të adresojë njoftimin e saj tek Huamarrësi brenda 30 ditëve të marrjes së njoftimit sipas nenit 8.02.

1.18 B Mekanizmi i parapagimit

Çdo shumë e kërkuar nga Banka, në përputhje me nenin 4.03A, së bashku me interesin e akumuluar, do të paguhet në datën e treguar nga Banka, datë e cila nuk duhet të bjerë në jo më pak se 30 ditë nga data e njoftimit të kërkesës së Bankës.

Nëse Huamarrësi parapaguan një transh në një datë tjetër nga ajo e një date relevante pagese, Huamarrësi duhet të dëmshpërblejë Bankën në një shumë të atillë që të verifikohet nga Banka si shumë e kërkuar për kompensimin e saj për tërheqjen e fondeve, në të kundërt në një datë relevante pagese.

1.19 Aplikimi i parapagesave të pjesshme

Nëse Huamarrësi parapaguan në mënyrë të pjesshme një transh, shuma e parapaguar duhet të aplikohet *pro rata* ose si opSION tjetër me renditje inverse të maturitetit për secilin këst të papaguar.

Nëse Banka kërkon një parapagesë të pjesshme të huasë, Huamarrësi, në përputhje me kërkesën, duke e paraqitur atë pranë Bankës, si dhe duke bërë njoftimin në Bankë brenda pesë ditëve biznesi Luksemburgu nga marrja e kërkesës prej Bankës, mundet të zgjedhë transhet për t'u parapaguar dhe të ushtrojë opSIONIN për aplikimin e shumës së parapaguar.

## Neni 2 Pagesat

1.20 Përcaktimi i datës së pagesës

Në këtë kontratë:

“Data e pagesës” në lidhje me secilin transh nënkupton çdo datë në mes të vitit të specifikuar në njoftimin për disbursim, ku për një transh VSFR nënkupton çdo ditë të parë të tremujorit, ku në cilindo vit një datë e tillë nuk është një ditë relevante biznesi, që nënkupton dita pas ditës relevante të biznesit, pa rregullime të interesave të papaguara sipas nenit 3.01.



“Ditë relevante biznesi” nënkupton:

i) Për euron, një ditë në të cilën operon sistemi TARGET Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer; dhe

ii) Për çdo lloj monedhe tjetër, një ditë në të cilën bankat janë të hapura për biznes normal në qendrat kryesore financiare të vendit që aplikon monedhën në fjalë.

#### 1.21 Marrëveshja e llogaritjes së ditëve

Çdo shumë e papaguar interesi, zhdëmtim apo pagesë nga ana e Huamarrësit nën këtë kontratë, dhe llogaritur në lidhje me fraksionin e vitit, do të përcaktohet sipas marrëveshjeve respektive të mëposhtme:

i) Për një transh VSFR, 360 ditë dhe numri i ditëve të kaluara;

ii) Për një transh me përqindje fikse, një vit me 360 ditë dhe një muaj me 30 ditë.

#### 1.22 Koha dhe vendi i pagesës

Të gjitha shumatat me përjashtim të interesave, gjobat dhe principali janë të pagueshme brenda shtatë ditëve kur Huamarrësi merr kërkesën e Bankës.

Çdo shumë e pagueshme nga Huamarrësi nën këtë kontratë do të paguhet në llogarinë respektive që i njoftohet Huamarrësit nga Banka. Banka duhet të përcaktojë llogarinë jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë para afatit të skadimit për pagesën e parë nga Huamarrësi dhe duhet të njoftojë çfarëdo ndryshimi të llogarisë në jo më pak se pesëmbëdhjetë ditë para datës së pagesës së parë mbi të cilën aplikohet ndryshimi. Kjo periudhë njoftimi nuk aplikohet në rastin e pagesave që kryhen sipas nenit 10.

Shuma e papaguar nga Huamarrësi duhet konsideruar e paguar vetëm kur Banka e merr atë.

Sipërmarrjet e Huamarrësit

#### 1.23 Përdorimi i huasë dhe fondeve të tjera

Huamarrësi duhet të përdorë burimet e huasë ekskluzivisht për zbatimin e projektit.

Huamarrësi nuk duhet të përdorë burimet e Huasë për shpronësim toke dhe/apo taksat mbi vlerën e shtuar.

Huamarrësi duhet të garantojë se ka në dispozicion përveç huasë edhe fonde të tjera të renditura në pjesën (3) dhe se fonde të tilla janë në sasinë e kërkuar mbi financimin e projektit.

#### 1.24 Përfundimi i projektit

Huamarrësi do të realizojë projektin në përputhje me përshkrimin teknik, siç do të modifikohet herë pas here me aprovim nga Banka dhe Huamarrësi, dhe do ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar.

#### 1.25 Rritja e kostos së projektit

Nëse kostoja totale e projektit tejkalon shifrën e përlllogaritur të paraqitur në pjesën (2), Huamarrësi do të mbajë fondet për të financuar koston e tejkualuar pa kërkuar mbështetje nga Banka, pra për të mundësuar mbarimin e projektit në përputhje me përshkrimin teknik. Planet e Huamarrësit për të financuar koston shtesë duhet të dorëzohen për informim në kohë te Banka

#### 1.26 Procedura e prokurimit

Huamarrësi do të blejë pajisje, të garantojë shërbime, si dhe të realizojë punime për projektin përmes tenderave të hapur ndërkombëtarë apo procedurave të tjera të prokurimit të zbatueshme në përputhje me kërkesat e Bankës, me politikën e saj, ashtu siç përshkruhet në udhëzuesin e saj të prokurimeve, të hyrë në fuqi në datën e kësaj kontrate, siç është prezantuar në *website*.

#### 1.27 Vazhdimi i sipërmarrjeve nga projekti

Për aq kohë sa huaja është e papaguar, Huamarrësi duhet të garantojë se mbështetësi duhet:

i) Mirëmbajtja: të mirëmbajë, riparojë, rishikojë dhe rifreskojë të gjitha pjesët në pronësi të projektit, ashtu siç kërkohet për t'i mbajtur ato në kushte të mira pune;

ii) Sigurimi: të sigurojë se të gjitha punët dhe pjesët në pronësi të projektit të realizuara prej tij do të sigurohen në formën e duhur në përputhje me praktikën normale për punë të ngjashme me interes publik;

iii) Asetet e projektit: me përjashtim të rasteve kur Banka do të japë miratimin e saj me shkrim, e drejta dhe pronësia e të gjitha apo kryesisht të gjitha asetëve që përbëjnë projektin, sikurse

dhe e drejta për zëvendësimin apo rinovimin e aseteve të tilla mbetet te mbështetësi, duke mbajtur projektin vazhdimisht në operim të qëndrueshëm në përputhje me qëllimin e tij fillestar; duke pasur parasysh se Banka mund të refuzojë pëlqimin e saj vetëm atëherë kur veprimi i propozuar do të dëmtojë interesat e Bankës si Huadhënës te Huamarrësi apo mund ta bëjë projektin të papërshtatshëm për t'u financuar nga Banka sipas statutit apo sipas nenit 267 të Traktatit të Romës; dhe

iv) Të drejtat dhe autorizimet: mban në forcë të gjitha të drejtat e përdorimit, si dhe të gjitha autorizimet e nevojshme për të realizuar dhe zbatuar projektin; dhe

v) Mjedisi: zbaton dhe vë në veprim projektin në përputhje me ligjet e Bashkimit Europian në drejtim të zbatimit, si dhe në përputhje me ligjet e Huamarrësit apo të specifikuara nga Banka para datës së kësaj kontrate, të aplikueshme me traktatet ndërkombëtare, nga të cilat një objektiv kryesor ka të bëjë me ruajtjen, mbrojtjen apo përmirësimin e mjedisit; për qëllime të të cilit "Mjedisi" nënkupton si më poshtë: a) kushtet e jetesës së njerëzve; b) fauna dhe flora; c) cilësia e tokës, ujit, ajrit, klimës dhe terrenit; dhe d) trashëgimia kulturore, si dhe mjedisi rrethues; si dhe përfshin kushtet e punës së punonjësve që merren me projektin, si dhe ndikimin e tij social; dhe

vi) Ligji i përgjithshëm: bën që projekti të ekzekutohet dhe të veprojë me qëllim që t'i përqaset parimeve të ligjit të BE-së direkt të aplikueshme për Huamarrësin dhe projektin, siç zbatohet në ligjet e Huamarrësit.

#### 1.28 Sipërmarrjet e përgjithshme të projektit

##### Huamarrësi:

i) deri më 30 qershor 2006, duhet të zhvillojë një program kombëtar mbi ristrukturimin e transportit koherent dhe të integruar, duke përfshirë një plan veprimi të detajuar bazuar në Planin Kombëtar të Transporteve për të drejtuar zhvillimet, veprimet administrimin dhe menaxhimin e sektorit të rrugëve. Një program i tillë duhet të jetë i pranueshëm nga Banka si në formë, dhe në përmbajtje dhe duhet të zbatohet në përputhje me kalendarin e veprimeve;

ii) duhet t'i paraqesë Bankës një program mirëmbajtjeje dhe investimesh trevjeçar për rrjetin kombëtar të rrugëve: i) në draft më apo para datës 15 tetor të çdo viti nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, dhe ii) më apo para datës 31 janar të çdo viti nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, siç është aprovuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit;

iii) duhet të garantojë se niveli i shpenzimeve vjetore për mirëmbajtjen e rrugëve shtetërore duhet të mos jetë më pak se 10,000,000 euro (dhjetë milionë euro) për vitin fiskal 2006 dhe jo më pak se 12,000,000 euro (dymbëdhjetë milionë euro) për vitin fiskal 2008;

iv) duhet të paraqesë më apo para datës 30 qershor 2006, në formë e përmbajtje në përputhje me kërkesat e Bankës, një strategji për riformimin e financimit të sektorit të rrugëve; dhe

v) duhet të sigurojë se më 31 dhjetor 2006 strategjia për riformimin e financimit të sektorit të rrugëve është aprovuar nga Këshilli i Ministrave i Huamarrësit.

#### 1.29 Njësia e zbatimit të projektit

Huamarrësi do të mbajë PIU-n ekzistent me një nivel fillestar stafi siç kërkohet nga Banka e deri në përfundim të projektit.

#### 1.30 Angazhimi për integritet

Huamarrësi garanton dhe merr përsipër se nuk është i angazhuar dhe se nuk ka dijeni që ndonjë person të jetë i angazhuar në ndonjë prej akteve të mëposhtme dhe se nuk do të angazhohet në të ardhmen, si dhe asnjë person, me aprovim apo dijeni të tij, nuk do të ndër marrë ndonjë akt të tillë si më poshtë:

i) Ofrimi, dhënia, marrja apo kërkimi i ndonjë avantazhi të pamërituar që do të influenconte veprimin e ndonjë personi që mban një zyrë apo funksion publik, apo një drejtor ose punonjës me autoritet publik sikurse dhe ndërmarrje publike, apo një drejtor ose zyrtar i një organizate publike ndërkombëtare të lidhur me çfarëdo procesi prokurimi apo me ekzekutimin e çfarëdo kontrate në përputhje me ato elemente të projektit të përshkruar në përshkrimin teknik; ose

ii) Çdo akt që, në mënyrë të padrejtë, influencon procesin e prokurimit ose synon të influençojë procesin e prokurimit apo zbatimin e projektit në dëm të Huamarrësit, ku përfshihet dhe marrëveshja e fshehtë midis tenderuesve.

Për këtë qëllim, njohuria e zyrtarit të përmendur në nenin 12.03 do të paraprijë njohurinë e

Huamarrësit. Huamarrësi merr përsipër të informojë Bankën nëse duhet të vihet në dijeni për fakte apo informacione që të kujtojnë mandatin e cilitdo akti të tillë.

## Neni 2 **Siguria**

### 1.31 Siguria

Nëse Huamarrësi do t'i dhurojë cilësdo pale të tretë sigurinë për realizimin e cilitdo prej detyrimeve të borxhit të jashtëm apo ndonjë preference apo prioriteti, Huamarrësi duhet të informojë Bankën dhe nëse i kërkohet nga Banka, duhet t'i paraqesë asaj siguri ekuivalente për realizimin e detyrimeve apo t'i dhurojë Bankës preferencën apo prioritetin ekuivalent.

Huamarrësi siguron se aktualisht nuk ekziston asnjë prej interesave të sigurisë, preferencave apo prioriteteve.

## Neni 2 **Informacioni dhe vizitat**

### 1.32 Informacion lidhur me projektin

Huamarrësi:

i) duhet të dorëzojë para Bankës: a) informacionin në formë, përmbajtje dhe kohë sipas specifikimeve në listën A.2 ose në të kundërt, siç mund të bihet dakord herë pas here nga Palët në këtë kontratë, dhe b) çdo informacion të tillë apo ndonjë dokument lidhur me financat, prokurimet, zbatimin, veprimin dhe ndikimin mjedisor të projektit që mund të kërkohen nga ana e Bankës;

ii) duhet të paraqesë në kohë për aprovim nga Banka çdo ndryshim çmimi, dizenjimi, plani, afati kohor apo programi shpenzimesh për projektin, në përputhje me paraqitjen e tyre te Banka para nënshkrimit të kësaj kontrate;

iii) duhet të paraqesë te Banka, nëse i kërkohet: a) certifikatë të siguruesve, duke treguar përmbushje të kërkesave të nenit 6.05 (ii) dhe b) çdo vit një listë të politikave në fuqi që mbulon pasurinë e siguruar që formon pjesë të projektit, së bashku me konfirmimin e pagesës së kësteve aktuale;

iv) në kohë, duhet të informojë Bankën: a) mbi çfarëdo çështje gjyqësore që është realizuar apo ngrihet kundër saj lidhur me çështjet e mjedisit apo çështje të tjera që ndikojnë mbi projektin; ose b) çdo fakt apo ngjarje që dihet nga Huamarrësi dhe që mundet në mënyrë thelbësore të dëmtojë apo ndikojë në kushtet e zbatimit apo operimit të projektit;

v) duhet të paraqitet në Bankë, çdo datë 31 mars dhe 30 shtator, një plan zbatimi, ku të përfshihet një përmbledhëse e progresit fizik të projektit, si dhe progresit financiar dhe/ose çfarëdo çështje teknike që mund të ndikojë mbi progresin, koston apo realizimin e projektit në mënyrë materiale; dhe

vi) duhet të dorëzojë pranë Bankës, brenda gjashtë muajve në vijim të përfundimit të zbatimit të projektit, një raport ku të përcaktohet se projekti ka përfunduar si i plotë, si dhe të përfshihet një përmbledhëse e (1) punëve të kryera, si dhe e kostos së tyre respektive, dhe (2) kontributet financiare të bëra nga Banka, BERZH-i, Huamarrësi, si dhe ndonjë financues tjetër sipas rastit.

### 1.33 Informacioni lidhur me Huamarrësin

Huamarrësi duhet të informojë Bankën:

a) menjëherë lidhur me çfarëdo vendimi të ndërmarrë për çfarëdo arsyeje, për ndonjë rast që e detyron atë, si dhe për çdo kërkesë bërë ndaj tij për parapagimin e ndonjë huaje;

b) çdo intension nga ana e tij për të refuzuar mbi pronësinë mbi cilindo komponent material të projektit; dhe

c) përgjithësisht mbi ndonjë fakt apo ngjarje që mund të parandalojë përmbushjen e çfarë detyrimi të Huamarrësit nën këtë kontratë.

Huamarrësi duhet të sigurojë se librat e llogarisë reflektojnë plotësisht operacionet që lidhen

me veprimet financiare, ekzekutimin dhe veprimin e projektit.

#### 1.34 Vizitat nga Banka dhe dokumentet

Huamarrësi duhet të lejojë persona të caktuar nga Banka, që mund të jenë të shoqëruar nga përfaqësuesit e Trupit të Auditimit të Komisionit Europian (që në këtë dokument do të quhet “Trupi”), të kryejnë vizita në terren, të shohin vendosjen, si dhe punimet, si dhe të realizojnë kontrolle të tilla sipas dëshirës, po ashtu t’u japin atyre apo të garantojnë se do t’u japin të gjithë asistencën a nevojshme për këtë qëllim.

Huamarrësi pranon që Banka mund të jetë e detyruar të shpërndajë dokumente të tilla që lidhen me Huamarrësin apo projektin të Trupit, pasi ato janë të domosdoshme për realizimin e detyrave të Trupit në përputhje me ligjin e Bashkimit Europian.

#### 1.35 Investigimet dhe informacioni

Huamarrësi merr përsipër:

i) të kryejë veprime të tilla, pasi Banka në mënyrë të logjikshme do të kërkojë të investigojë dhe/apo të ndërpresë çdo akt të pretenduar apo të dyshimtë të tipit të përshkruar në nenin 6.08;

ii) të informojë Bankën mbi masat e marra për të kërkuar mbi dëmet e personave përgjegjës çfarëdo humbje të shkaktuar nga akte të tilla; dhe

iii) të lehtësojë çfarëdo investigimi që Banka mund të kryejë lidhur me çfarëdo akti të tillë.

Huamarrësi do të jetë përgjegjës për kontaktet me Bankën për qëllime të nenit 6.08, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi specifikon të kundërtën me shkrim pranë Bankës.

## Neni 2

### **Pagesat dhe shpenzimet**

#### 1.36 Taksat, detyrimet dhe tarifat

Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifat, si dhe çfarëdo detyrimi tjetër të kësaj natyre, duke përfshirë dhe pagesat për vulën, tarifat e regjistrimit apo çdo detyrim tjetër të kësaj natyre që është i nevojshëm për zbatimin e kësaj kontrate apo çfarëdo dokumenti tjetër lidhur me të, si dhe në krijimin e çfarëdo sigurie mbi huanë.

Huamarrësi do të paguajë të gjithë principalin, interesat, dëmshpërblimet, si dhe kamatvonesat nën këtë kontratë pa zbritje të çfarëdo detyrimi kombëtar apo lokal; duke pasur parasysh se nëse Huamarrësi është i detyruar të bëjë një zbritje të tillë, ajo do të jetë pjesë bruto e pagesës për Bankën, kështu që pas zbritjes, shuma neto e tërhequr nga Banka është e barabartë me shumën e papaguar.

#### 1.37 Pagesa të tjera

Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat dhe shpenzimet, duke përfshirë ato profesionale, të veprimeve bankare apo ato të shkëmbimit monetar që ndodhin në përputhje me përgatitjen dhe zbatimin e kësaj kontrate apo çfarëdo dokumenti të lidhur me të, si dhe në krijimin, regjistrimin, perfeksionimin, menaxhimin dhe realizimin e çfarëdo sigurie për huanë, sikurse dhe të çfarëdo shpenzimi nga Banka sipas nenit 8.04.

Banka do të japë mbështetje të dokumentuar për çdo pagesë të tillë apo shpenzim katërmëdhjetë ditë para afatit të kërkesës së saj për pagesë.

## Neni 2

### **Parapagesat në rast vonesash**

#### 1.38 E drejta për të kërkuar ripagesë

Huamarrësi do të ripaguajë huanë apo çfarëdo pjese të saj menjëherë, së bashku me interesin mbi të, mbi bazën e kërkesës me shkrim të përgatitur nga Banka në përputhje me parashikimet e mëposhtme të nenit 10.

#### 1.38 A Kërkesa e menjëhershme

Banka mund të përgatisë këtë kërkesë menjëherë:

i) nëse Huamarrësi dështon në ripagimin e çfarëdo pjese të huasë në afat, për të paguar interesat mbi të apo për të bërë çfarëdo pagese tjetër për Bankën siç është paraqitur këtu;

ii) nëse informacioni apo ndonjë dokument i paraqitur pranë Bankës, nga apo në emër të Huamarrësit lidhur me negociimin e kësaj kontrate apo gjatë jetë gjatësisë së saj, vërtetohet se ka qenë jo korrekt në çfarëdo pjese të tij të veçantë;

iii) nëse Huamarrësi dështon në realizimin e çfarëdo detyrimi financiar lidhur me çfarëdo huaje (me përjashtim të huasë) realizuar për të nga Banka apo Bashkimi Europian dhe nëse në vijim të cilitdo dështimi lidhur me këtë çështje, Huamarrësit i kërkohet të parapaguajë çdo hua tjetër apo të çlirojë para maturitetit çdo borxh të krijuar nga një transaksion financiar;

iv) nëse në vijim të një dështimi nga ana e Huamarrësit, lidhur me realizimin e çfarëdo detyrimi lidhur me çfarëdo hua dhe/ose grant sipas pjesës (3), e drejta e Huamarrësit për tërheqjen e vazhdimet të kësaj huaje apo të një granti të tillë, do të anulohet apo ndërpritet, ose nëse kjo hua apo një grant i tillë do të bëhet i ripagueshëm në përputhje me kështet e tij;

v) nëse ndodh ndonjë ngjarje apo situatë, mbi bazën e së cilës rrezikohet shërbimi i huasë apo mosfavorizim që ndikon mbi sigurinë e dhënë për të.

#### 1.38 B Kërkesa pas njoftimit për kompensim

Banka mundet gjithashtu të bëjë një kërkesë të tillë mbi çështje që nuk mund të rregullohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore të specifikuar në një njoftim dhënë nga Banka mbi Huamarrësin:

i) nëse Huamarrësi dështon të përmbushë detyrime materiale nën këtë kontratë dhe që nuk përbën një detyrim të përmendur në nenin 10.01A(i); ose

ii) nëse ndonjë fakt i cituar te pjesët ndryshon në mënyrë materiale apo nuk kthehet në mënyrë materiale dhe nëse ndryshimi dëmton interesat e Bankës si kreditues i Huamarrësit apo ndikon në zbatimin apo operimin e projektit.

#### 1.38 C Të drejta të tjera ligjore

Neni 10.01 nuk kufizon ndonjë të drejtë tjetër të Bankës mbi ligjin për të kërkuar parapagesën e huasë.

#### 1.39 Zhdëmtimi

##### 1.39 A Transhet me përqindje fikse

Në rast kërkesë, sipas nenit 10.01, lidhur me çfarëdo transhi me përqindje fikse, Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës një shumë të llogaritur në përputhje me nenin 4.02 B mbi çdo shumë së cilës i ka kaluar afati dhe është e pagueshme. Një shumë e tillë shtohet nga data e afatit për pagesë të specifikuar në njoftimin e kërkesës së Bankës dhe do të llogaritet mbi bazat ku parapagesa është efektive në një datë të specifikuar si e tillë.

##### 1.39 B Transhet VSFR

Në rast të kërkesës, sipas nenit 10.01, lidhur me një transh VSFR, Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës një shumë të barabartë me vlerën aktuale të 0.15% (pikë bazë 15) në vit, të llogaritura dhe të shtuara mbi shumën për t'u parapaguar në afat në të njëjtën mënyrë sikur interesi të ishte llogaritur dhe shtuar, nëse kjo shumë do të ishte e papaguar sipas skemës origjinale të amortizimit të transhit.

Një vlerë e tillë aktuale do të përcaktohet duke përdorur një përqindje diskaunti, të aplikuar sipas datës së pagesës relevante. Përqindja e diskauntit do të jetë përqindja fikse e aplikueshme një muaj para datës së parapagesës, duke pasur të njëjtat kushte pagese të interesit, si dhe të njëjtat kushte të datës së maturimit sikurse dhe shuma për t'u parapaguar.

##### 1.40 Të përgjithshme

Shumat e papaguara nga Huamarrësi, në përputhje me nenin 10.02, do të jenë të pagueshme në datën e parapagesës të specifikuar në kërkesën e Bankës.

##### 1.41 Mosheqje dorë

Asnjë dështim apo vonesë nga Banka në ushtrimin e cilësdo të drejthe të saj sipas nenit 10 nuk do të interpretohet si dorëheqje nga këto të drejta.

##### 1.42 Aplikimi i shumave të marra

Shumat e marra nga Banka, që ndjekin një kërkesë sipas nenit 10.01, do të zbatohen fillimisht në pagesën e shpenzimeve, interesave dhe dëmshpërblimeve dhe së dyti, në reduktimin e kësteve të papaguara në renditje inverse të maturitetit. Banka mund të aplikojë shumat e marra midis transheve me zgjedhjen e saj.

#### Neni 2

### **Ligji dhe juridiksioni**

#### 1.43 Ligji qeverisës

Kjo kontratë do të qeveriset nga ligjet e Luksemburgut.

#### 1.44 Juridiksioni

Palët këtu paraqiten pranë Trupit Gjykses të Komunitetit Europian.

#### 1.45 Evidencë mbi shumat e palikuiduara

Në çfarëdo veprimi ligjor dalë nga kjo kontratë, certifikata e Bankës për çfarëdo shume pa paguar Bankës sipas kësaj kontrate do të jetë evidencë parësore për një shumë të tillë.

#### 1.46 Marrëveshja e plotë

Kjo kontratë përbën një marrëveshje të plotë midis Palëve. Veprimet dhe përfaqësimet reciproke të kësaj kontrate zëvendësojnë të gjitha veprimet dhe përfaqësimet e mëparshme të bëra nga Palët lidhur me korrespondencën, diskutimet dhe negociatat që kanë çuar në konkluzionet e kësaj kontrate.

#### Neni 2

### **Klauzolat përfundimtare**

#### 1.47 Njoftimi për Palët

Njoftimet dhe dokumentacione të tjera të dhëna në adresë të secilës prej Palëve të kësaj kontrate duhet të dërgohen me shkrim në adresën përkatëse si më poshtë, apo në cilëndo adresë të njoftuar dërguesit më parë me shkrim:

- Për Bankën: 100 Bulevard Konrad  
Adenauer  
L- 2950 Luxembourg

- Për Huamarrësin: Bulevardi: "Dëshmorët e  
Kombit", Tirana  
Albania

#### 1.48 Forma e njoftimit

Njoftimet, si dhe komunikimet e tjera, për të cilat janë përcaktuar periudha fikse në këtë kontratë, apo të cilat vendosin periudha fikse mbi të adresuarin, do të dorëzohen në dorë, si letra të regjistruara, faksmiljet apo mënyra të tjera të transmetimit të cilat paraqesin evidencë marrjeje nga ana e marrësit. Data e regjistrimit ose, sipas rastit, data e vendosur e marrjes së dërgesës duhet të jetë vendimtare për përcaktimin e një periudhe.

Njoftimet e lëshuara nga Huamarrësi në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate duhet që, me kërkesë të Bankës, të dorëzohen në Bankë së bashku me evidencën e pranueshmërisë nga autoriteti i personit apo personave të autorizuar për të firmosur një njoftim të tillë në emër të Huamarrësit, si dhe firma e vërtetuar e një personi apo personave të tillë.

#### 1.49 Komunikimi mbi çështjet e integritetit

Vetëm me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi do të specifikojë ndryshe me shkrim për Bankën, Drejtori i Njësisë së Menaxhimit të Projektit të Programit PHARE dhe CARDS të Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit të Huamarrësit do të jetë përgjegjës për kontratat me Bankën për qëllimet e paraqitura në nenin 6.08.

#### 1.50 Pjesët dhe afati kohor

Pjesët dhe afatet kohore si pjesë e kësaj kontrate:

Pjesa A.1:	Përshkrimi teknik
Pjesa B:	Përkufizimet e EURIBOR
Pjesa C:	Formati i kërkesës për disbursim
Pjesa D:	Tabela e amortizimit

Në prani të dëshmitarëve, Palët kanë realizuar këtë kontratë për t'u zbatuar në origjinal në gjuhën angleze dhe në mënyrë respektive kanë zbatuar dhe për të firmosur çdo faqe të kësaj kontrate në emër të tyre.

Realizuar në Tiranë, më 2005

Pjesa A.1

## PËRSHKRIMI TEKNIK (NENI 6.02)

### Qëllimi, vendndodhja

Projekti përfshin rindërtimin e rrugës njëkalimshe midis Fierit dhe Tepelenës prej 70 km, rrugë e cila lidhet me Greqinë përgjatë aksit kryesor veri-jug. Ai përfshin ndërtimin e seksionit prej 37 km mbi një gjurmë të re në zonën midis Fierit dhe Dames. Qëllimi është të përmirësohet siguria, kapaciteti dhe koha e udhëtimit.

### Përshkrimi

Projekti përfshin ndërtimin e një seksioni në një rrugë të re njëkalimshe prej 37 km midis Fierit dhe Dames, si dhe rindërtimin e rrugës ekzistuese njëkalimshe me përmirësime përgjatë 33 km midis Damës dhe Tepelenës.

Rruga e re do të dizajnohet me standardet italiane, ku shpejtësia mesatarisht do të variojë nga 80 në 100 km/orë përgjatë seksionit, dhe ndoshta të mund të reduktohet në 60 km/orë në vende të veçanta duke marrë në konsideratë sigurinë në rrugë. Rruga ekzistuese do të rikonstruktohet tipikisht për një shpejtësi të dizajnuar me 60 km/orë, me disa seksione të shkurtra për shpejtësi prej 80 km/orë.

Gjerësia e korsisë	3.75 m (3.50 m për seksionet 60 km/orë)
Gjerësia ekstreme e anës së rrugës	1.50 m (1.25 m në seksionet 60 km/orë, e zëvendësuar me trotuare për kalimin e këmbësorëve në fshatra )
Gjerësia e anëve të rrugës	1.50 m

Korsitë në ngjitje dhe ato të daljes do të realizohen në vende të caktuara sipas nevojës me kryqëzime që do të adoptohen sipas rastit.

### Kalendari

Ndërtimi pritet të përfundojë në dhjetor 2009.

Pjesa A.2  
(1/2)

Informacion i kërkuar sipas nenit 8.01  
INFORMACION MBI PROJEKTIN PËR T'U PARAQITUR PRANË BANKËS DHE  
MËNYRA E DËRGIMIT

1. Dërgimi i informacionit: emërimi i personit përgjegjës  
Informacioni i mëposhtëm duhet dërguar pranë Bankës nën përgjegjësinë e:

Kompania	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
Personi i kontaktit	Z. Artur Luca
Titulli	Drejtor i PMU-së
Funksioni/ departamenti	Drejtor, Phare, CBC & Programet e Transportit
Adresa	Zyra e Transportit PMU Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit Bul.: "Dëshmorët e Kombit", Hotel Dajti, nr.205 Tirana Albania
Telefon	+355 4 234955 (Mobile +355 68 20 24281)
Fax	I njëjtë me telefonin
E-mail	

Personi i kontaktit i përmendur më lart është personi përgjegjës sot për sot.  
Huamarrësi duhet të informojë BEI-n menjëherë në rast të ndonjë ndryshimi të personit të kontaktit.

2. Informacion mbi zbatimin e projektit

Huamarrësi duhet t'i dorëzojë Bankës informacionin në vijim mbi progresin e projektit gjatë zbatimit së paku brenda afatit të paraqitur më poshtë.

Dokumenti/informacioni	Afati	Frekuenca e raportimit
Raporti mbi progresin e projektit: - Një përmbledhje e shkurtër mbi përshkrimin teknik, duke shpjeguar dhe arsyet për ndryshime thelbësore krahasuar me qëllimin fillestar; - Rifreskim i datës së përfundimit për përfundimin e secilit nga komponentët kryesorë, duke shpjeguar dhe arsyet për ndonjë vonesë të mundshme; - Rifreskim i kostos së projektit, duke shpjeguar dhe arsyet për ndonjë rritje të mundshme të koston krahasuar me koston në buxhetin fillestar; - Një përshkrim i cilitdo problem themelor me ndikim mbi mjedisin; - Rifreskim mbi procedurat e prokurimit (jashtë BE-së); - Rifreskim mbi kërkesat, trajtimet dhe komentet; - Çdo çështje sinjifikative që ka ndodhur, si dhe çdo risk sinjifikativ që mund të ndikojë operimin e	Jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të secilës periudhë raportimi	Çdo tremujor gjatë vitit të parë të zbatimit, dhe më vonë dy herë në vit, nëse bihet dakord me Bankën



projektit; - Çdo veprim ligjor lidhur me projektin që mund të jetë në veprim.		
Raporti mjedisor lidhur me projektin	31 mars	vjetor

Lista A.2 (2/2)

3. Informacion mbi subjektet specifike

Huamarrësi duhet t'i japë Bankës informacionin në vijim, brenda afatit të përshkruar më poshtë.

Dokumenti/informacioni	Afati
Draftprogrami trevjeçar mbi mirëmbajtjen dhe investimet për rrjetin kombëtar të rrugëve	15 janar, çdo vit gjatë zbatimit të projektit
Programi përfundimtar trevjeçar mbi mirëmbajtjen dhe investimet, aprovuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	31 mars, çdo vit gjatë zbatimit të projektit

4. Informacion mbi përfundimin e punimeve dhe vitin e parë të operimit

Huamarrësi duhet t'i paraqesë Bankës informacionin në vijim mbi përfundimin e projektit, si dhe vitin e parë të operimit, brenda afatit të përshkruar më poshtë:

Dokumenti / informacioni	Data e dorëzimit në Bankë
Raporti i përfundimit të projektit, duke përfshirë: - një përshkrim të shkurtër të karakteristikave teknike të projektit të përfunduar, duke shpjeguar dhe arsyet për ndonjë ndryshim sinjifikativ; - datën e përfundimit të secilit prej komponentëve kryesorë të projektit, duke shpjeguar arsyet për çfarëdo vonese; - koston përfundimtare të projektit, duke shpjeguar arsyet për çfarëdo rritje të mundshme të koston krahasuar me koston e buxhetit fillestar; - numrin e vendeve të reja të punës të krijuara nga projekti, si të atyre krijuar gjatë zbatimit, ashtu dhe atyre të përhershme; - përshkrimin e problemeve të rëndësishme me ndikim në mjedis; - rifreskimin e procedurave të prokurimit; - rifreskimin e kërkesave të projektit, trajtimet dhe komentet gjatë vitit të parë të operimit; - çdo çështje sinjifikative që ka ndodhur, si dhe çfarëdo risku sinjifikativ që mund të ndikojë operimin e projektit; - çdo akt ligjor lidhur me projektin që mund të jetë në veprim.	Jo më vonë se 15 muaj pas përfundimit të projektit, me të dhëna operative (të trafikut) që mbulojnë vitin e parë të operimit.
Gjuha e raportit	Anglisht

## Lista B

### PËRCAKTIMI I EURIBOR-IT

“EURIBOR” nënkupton:

i) në përputhje me cilëndo periudhë relevante, duke përfshirë dhe periudhën e referencës VSFR, të një muaji apo më tepër, përqindja e interesave për depozitat në euro për një kësht që përfaqëson numrin e të gjithë muajve dhe që i korrespondon më afër gjatësisë së periudhës, dhe;

ii) në përputhje me një periudhë relevante prej më pak se një muaj, përqindja e interesit për depozitat në euro për një kësht prej një muaji,

(periudha në të cilën konsiderohet interesi, e quajtur në këtë dokument “Periudha përfaqësuese”), siç paraqitet në orën 11.00 të mëngjesit sipas orës së Brukselit ose në një orë të mëvonshme të pranueshme nga Banka lidhur me ditën (data e rivendosur), e cila bie dy ditë biznesi relevante para ditës së parë të periudhës relevante, te faqja Reuters e EURIBOR-it 01 apo faqja pasuese, apo në mungesë të së cilës, përmes çdo mjeti tjetër të publikuar të përzgjedhur nga Banka për këtë qëllim.

Nëse një interes i tillë nuk është publikuar në këtë formë, Banka u kërkon zyrtarisht qendrore të eurozonës nga katër banka qendrore në eurozonë, të përzgjedhura nga Banka, të kuotojnë interesin në të cilin depozitat euro në një shumë të krahasueshme ofrohen prej secilës prej tyre në orën 11:00 të paradites me orën e Brukselit, mbi datën e rivendosur për bankat kryesore në eurozonën të tregut interbankar për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse jepen së paku dy kuota, atëherë interesi për datën e rivendosur do të jetë një mesatare aritmetike e kuotimeve.

Nëse jepen më pak se dy kuotime, sipas kërkesës, interesi për datën e rivendosur do të jetë mesatarja aritmetike e interesave të kuotuar nga bankat kryesore të eurozonës, të përzgjedhura nga Banka, në orën 11:00 të paradites me orën e Brukselit, në datën në të cilën bien dy ditë relevante biznesi pas datës së rivendosur, për huatë në euro në një shumë të krahasueshme me banka kryesore europiane për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

Nëse ndonjë prej parashikimeve të mëparshme bëhet i papajtueshëm me parashikimet e adoptuara nën EURIBOR FBE dhe EURIBOR ACI, lidhur me EURIBOR, Banka, me anë të njoftimit që i bën Huamarrësit, mundet të amendojë parashikimin për ta përqasur atë me parashikimet e tjera.

Lista C

FORMATI I KËRKESËS PËR DISBURSIM (NENI 1.02B)

Nga Republika e Shqipërisë

Kërkesa për disbursim	Nr. i transhit:	Datë: ..
-----------------------	-----------------	----------

Lutemi procedoni me disbursimin e mëposhtëm:

Emri i huasë:	Projekti i rrugës Fier-Tepelene / A	Rezervuar për BEI-n	
Data e nënshkrimit:	<input type="text"/>	Shuma e huasë:	EUR 35,000,000
Numri referencës:	<input type="text"/>	Disbursuar deri sot:	<input type="text"/>
Numri disbursimit:	<input type="text"/>	Balanca për disbursim:	<input type="text"/>
Data e propozuar për disbursim:	<input type="text"/>	Afati i kërkesave për disbursim:	30 nëntor 2009
Totali i kërkuar (monedha e kontraktuar):	<input type="text"/>	Numri maksimal i disbursimeve:	15
Për t'u disbursuar si më poshtë:		Madhësia minimale e transhit:	EUR 2,000,000
Monedha (neni 1.03)	EUR	Totali i shpërndarë deri sot:	<input type="text"/>
Shuma	<input type="text"/>	Kushtet paraprirëse:	Shih nenin 1.05
Baza e përqindje së interesit (neni 3.01)	Përqindje fikse VSFR		
Frekuenca e interesit (neni 3.01)	Vjetor Gjashtëmuor Tremujor		
Ripagesa (neni 4.01)	Vjetore Periodikisht baza të tjera		
Datat e pagesës (neni 5.01)	Vjetore gjashtëmuore		
Data e parë e ripagesës	<input type="text"/>		
Data e ripagesës së fundit	<input type="text"/>		

Llogaria e Huamarrësit që do të kreditohet: N° llog.:

Emri dhe adresa e Bankës:

Lutemi kaloni informacionin mbi kërkesën te:

Emri (at) dhe firma(t) e(të) autorizuarit(ve) nga Huamarrësi:

Lista D

TABELA E SHLYERJEVE

Numri i kësteve	Data e pagesës	Shuma për t'u paguar e shprehur si përqindje ndaj huasë
1	15/12/2011	2.63 %
2	15/06/2012	2.63 %
3	15/12/2012	2.63 %
4	15/06/2013	2.63 %
5	15/12/2013	2.63 %
6	15/06/2014	2.63 %
7	15/12/2014	2.63 %
8	15/06/2015	2.63 %
9	15/12/2015	2.63 %
10	15/06/2016	2.63 %
11	15/12/2016	2.63 %
12	15/06/2017	2.63 %
13	15/12/2017	2.63 %
14	15/06/2018	2.63 %
15	15/12/2018	2.63 %
16	15/06/2019	2.63 %
17	15/12/2019	2.63 %
18	15/06/2020	2.63 %
19	15/12/2020	2.63 %
20	15/06/2021	2.63 %
21	15/12/2021	2.63 %
22	15/06/2022	2.63 %
23	15/12/2022	2.63 %
24	15/06/2023	2.63 %
25	15/12/2023	2.63 %
26	15/06/2024	2.63 %
27	15/12/2024	2.63 %
28	15/06/2025	2.63 %
29	15/12/2025	2.63 %
30	15/06/2026	2.63 %
31	15/12/2026	2.63 %
32	15/06/2027	2.63 %
33	15/12/2027	2.63 %
34	15/06/2028	2.63 %
35	15/12/2028	2.63 %
36	15/06/2029	2.63 %
37	15/12/2029	2.63 %

## ANEKSI NR.5

**TË DHËNA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËN E DËMEVE TË KONSTATUARA  
NË TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT  
TË VITIT 2004.**

milione lekë

1.	Dëmet e shkaktuara në sistemin e doganave	799.8
2.	Detyrime të zbuluara në sistemin e tatim taksave	1,017
3.	Dëme të konstatuara në:	
	-Privatizime objektsh nga AKP	5.2
	-Dhënje më qira	7.3
	-Shitje Apartamentesh nga EKB	31.8
	-Në fushën e Urbanistikës	57.4
4.	Dëme të konstatuara ne institucione për:	
	-shpenzimet për paga e shpërblime	12.9
	-shpenzime operative dhe mirëmbajtje	150.8
	-ne zbatimin e procedurave të prokurimit	103.2
	-ne financimin e huaj	75
5.	Detyrim i KESH për subvencionin e marrë tepër	173
6.	Dëme ekonomike të konstatuara në shpenzimet e organeve të pushteti vendor	12.2
	<b>GJITHSEJ:</b>	<b>2,445,6 milione leke</b>

**TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MBI DETYRIMET DEBITORE DERI MË  
DATËN 31.12.2004**

milione lekë

1.	Detyrime debitore të sektorit të doganave	4,650
2.	Detyrime debitore të sektorit të tatim taksave	20,268
3.	Detyrime debitore nga privatizimet ose dhënia me qira e pasurisë shtetërore	1,730.6
4.	Detyrime nga dividend i paderdhur.	750.9
5.	Detyrime debitore nga subvencioni i marrë tepër	2,431.4
6.	Detyrime debitore të ISSH-së	7,233
	Nga këto:	
	-Detyrime debitore për kontribute	3,418
	-Kamatë vonesat	3,815
7.	Vlera e kontributeve e përlogaritur për 18 204 punonjes ilegalë të zbuluar nga kontrollet	895.4
	<b>GJITHSEJ:</b>	<b>37,959.3 milionë lekë</b>

*Shënim: Konvertimi i vlerave të dëmeve në valutë është bërë me kursin aktual.*

## FJALORI I SHKURTIMEVE

AMC	Albanian Mobile Communication
AKP	Agjencia Kombëtare e Privatizimit
BB ose WB	Banka Botërore
BEI ose EIB	Banka Europiane e Investimeve
BERZH ose EBRD	Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FZSHH	Fondi i Zhvillimit Shqiptar
IDA	Organizata Ndërkombëtare për Zhvillim
INSTAT	Instituti i Statistikave
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditit
IKSH	Instituti i Kujdesit Shëndetsor
ISKSH	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
ISHP	Inspektoriati Shtetëror i Punës
2KR	Projekti i Rritjes së Prodhimit Ushqimor
KASH	Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
KESH	Kooperata Elektroenergjetike Shqiptare
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KKRT	Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit
KM	Këshilli i Ministrave
KML	Komisioni Mjeko-Ligjor
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PBA	Projektbuxheti Afatmesëm
PBB ose GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PMU	Njësia e Menaxhimit të Projektit
QNK	Qendra Ndërkombëtare e Kulturës
QSUT	Qendra Spitalore Universitare Tiranë
SKZHES	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social
T.v.sh.	Tatimi mbi vlerën e shtuar
VAM	Vlera Aktuale Minimale
ZABGJ	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

**LIGJ**  
**Nr.9728, datë 10.5.2007**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE  
PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E TRANSPORTIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për projektin e transportit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5325, datë 22.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE FINANCIMI**  
**(PROJEKT TRANSPORTI) NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS**  
**NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM**  
Datë \_\_\_\_\_,2006

Marrëveshje e datës \_\_\_\_, 2006 ndërmjet SHQIPËRISË (Përfituesi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata). Përfituesi dhe Shoqata bien dakord si më poshtë:

*ndërsa përfituesi* i ka kërkuar edhe Bankës të japë asistencë shtesë për financimin e projektit dhe me një marrëveshje me datë të njëjtë ndërmjet Përfituesit dhe Bankës (Marrëveshja e huasë), Banka bie dakord ta japë një asistencë të tillë në një shumë principale të plotë të barabartë me pesëmbëdhjetë milionë e treqind mijë euro (15 300 000 euro) (Huaja).

Neni 1

**Kushte të përgjithshme, përkufizime**

1.01 Kushtet e përgjithshme (sipas përcaktimit në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa të mëdha të përdorura në Marrëveshjen e financimit kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet e përgjithshme, ose në shtojcën 1664

e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 2 **Financimi**

2.01 Shoqata bie dakord t'i japë Përfituesit, me termat dhe kushtet e përcaktuara ose referuara në këtë Marrëveshje, një kredi në shumën ekuivalente të tre milionë e katërqind mijë të drejta të veçanta tërheqjeje (3 400 000 SDR) (Kredia) për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në planin 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat nga kredia në pajtim me seksionin V të planit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa maksimale e angazhimit që paguhet nga Përfituesi mbi balancën e kredisë së patërhequr është një e dyta e njëpërqindëshit (1/2 e 1%) në vit.

2.04 Tarifa e shërbimit që paguhet nga Përfituesi mbi bilancin e tërhequr të kredisë është e barabartë me tre të katërtat e njëpërqindëshit (3/4 e 1%).

2.05 Datat e pagesës janë 15 maji dhe 15 nëntori i çdo viti.

2.06 Shuma principale e kredisë shlyhet në pajtim me planin e shlyerjes të parashikuar në planin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Monedha e pagesës është euro.

## Neni 3 **Projekti**

3.01 Përfituesi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi, me anë të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, zbaton projektin në pajtim me dispozitat e nenit IV të kushteve të përgjithshme.

3.02 Pa u kufizuar nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe nëse Përfituesi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Përfituesi siguron që projekti të kryhet në pajtim me dispozitat e planit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 4 **Hyrja në fuqi, prishja**

4.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen sa më poshtë:

a) Marrëveshja e huasë është përfunduar dhe dorëzuar dhe të gjitha kushtet para hyrjes së saj në fuqi janë përmbushur, të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje.

b) Marrëveshja e bashkëfinancimit është përfunduar dhe dorëzuar dhe të gjitha kushtet para hyrjes në fuqi të saj ose të drejtës së Përfituesit për të bërë tërheqje në bazë të saj (të ndryshme nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së financimit dhe huasë) janë përmbushur.

4.02 Afati i fundit të hyrjes në fuqi është data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 5 **Përfaqësuesi, adresat**

5.01 Përfaqësuesi i Përfituesit është Ministri i Financave.



5.02 Adresa e Përfituesit është:  
Ministria e Financave  
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë, Shqipëri  
Faks +355 42 28 494

5.03 Adresa e Shoqatës është:  
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim  
1818 H Street, N.W.  
Washington, D.C. 20433  
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Adresa kabllore	Teleks	Faks
INDEVAS	248423(MCI) ose	1-202-477-6391
Washington, D.C,	64145 (MCI)	

rënë dakord më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, në ditën dhe vitin të shkruar më sipër

Shqipëri  
Nga \_\_\_\_\_  
Përfaqësues i autorizuar

Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim  
Nga \_\_\_\_\_  
Përfaqësuesi i autorizuar

## PLANI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e projektit janë: (a) pakësimi i shpenzimeve për përdoruesit e seksionit Milot-Rrëshen të korridorit Durrës-Morinë; (b) prezantimi i novacionit në zbatimin e ruajtjes së kontratës mbi bazë pilotimi; dhe (c) përmirësimi i kuadrit institucional, planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të aktiviteteve të sigurisë në rrugë në territorin e Përfituesit.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, që u nënshtrohen modifikimeve të tyre, siç mund të bien dakord Përfituesi dhe Shoqata, herë pas here, për të arritur këto objektiva:

Pjesa I. Ndërtimi i rrugës ndërmjet Milotit dhe Rrëshenit

Ndërtimi i një rruge ndërmjet qyteteve të Milotit dhe Rrëshenit, nëpërmjet sigurimit të punëve civile, mallrave dhe shërbimeve të konsulentëve.

Pjesa II. Mirëmbajtja e rrugës

Mirëmbajtja gjatë dimrit dhe mirëmbajtja rutinë e rrugëve në dy rajone pilot në territorin e Përfituesit me anë të kontratave bazuar mbi rezultatin dhe punën, duke siguruar punët civile dhe shërbimet e konsulentëve.

Pjesa III. Siguria në rrugë

Përmirësimi i sigurisë në rrugë në territorin e Përfituesit, duke përfshirë: (a) zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit; (b) kryerjen e auditivit të sigurisë në rrugë; dhe (c) forcimin e zbatimit të sigurisë në rrugë nga PMWTT-ja dhe policia rrugore, nëpërmjet dhënies së shërbimeve të konsulentëve, trajnimit dhe mallrave.

Pjesa IV. Forcimi i GRD-së dhe PMWTT-së

1. Forcimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, duke përfshirë PIT-in, për: (a) mbikëqyrjen e punëve civile dhe mirëmbajtjes së rrugëve sipas projektit; (b) menaxhimit të zyrës; dhe (c) menaxhimit të projektit, me anë të dhënies së shërbimeve të konsulentëve, trajnimit dhe mallrave, duke përfshirë vendet e kontrolluesit të trafikut dhe pajisjet për mbikëqyrjen e gjendjes së rrugës.

2. Mbështetja për MPWTT-në për të: (a) vlerësimi i boshllëqeve në sistemet e garancive të sektorit të rrugëve; (b) mbështetje për reformën e GRD-së; (c) trajnimi i personelit të projektit të MPWTT-së; dhe (d) mbështetje për ngritjen e një agjencie detare dhe zhvillimin e një ligji të ri për autoritetin e portit, me anë të dhënies së shërbimeve dhe trajnimit të konsulentëve.

## PLANI 2 EKZEKUTIMI I PROJEKTIT

### Seksioni I. Masat institucionale

Përfituesi zbaton projektin në pajtim me mekanizmat e mëposhtëm të bashkërendimit:

1. PIT-i brenda GRD-së është përgjegjëse për menaxhimin e përditshëm të projektit, duke përfshirë prokurimin, menaxhimin financiar, monitorimin dhe vlerësimin e projektit dhe menaxhimin e çështjeve të ambientit dhe sociale. Njësia e ambientit asiston me menaxhimin e projektit në lidhje me ambientin.

2. Përfituesi siguron që, gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit, GRD-ja, PIT-i dhe njësia e ambientit të jenë operacionale, me personel të përshtatshëm, financiar dhe mbajtur sipas termave të referencës që janë të pranueshme për Shoqatën.

### Seksioni II. Kërkesat e zbatimit

1. Përfituesi e zbaton projektin në pajtim me Planin e Menaxhimit të Ambientit, Planin e Veprimit për Rivendosjen dhe Planin e Zbatimit të Projektit dhe nuk ndryshon, pezullon, shfuqizon, anulon apo heq dorë nga ndonjë parashikim i Planit për Menaxhimin e Projektit, Planin e Veprimit të Rivendosjes ose Planit të Zbatimit të Projektit pa miratimin paraprak të Shoqatës.

2. Përfituesi: (a) jo më vonë se 30 qershori i vitit 2007, forcon punët për mbrojtjen nga përmbytjet në pjesën veriore të lumit të Matit; dhe (b) jo më vonë se 31 dhjetor 2007, forcon punët për mbrojtjen nga përmbytja në pjesën jugore të lumit të Matit, në një mënyrë të pranueshme për Shoqatën.

3. Pa u kufizuar nga dispozitat e zbatueshme të kushteve të përgjithshme, Përfituesi siguron që fonde të përshtatshme të alokohen në buxhetin vjetor të Huamarrësit për të mbuluar kontributin e Huamarrësit për financimin e projektit.

4. Përfituesi e rrit alokimin në buxhet për mirëmbajtjen e rrugëve me jo më pak se dhjetë (10) për qind në vit, në terma reale, krahasuar me një vit më parë, gjatë kohëzgjatjes së projektit, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe me Shoqatën.

5. Përfituesi, më 31 tetor të çdo viti gjatë zbatimit të projektit, i paraqet Shoqatës për rishikim dhe miratim programin e tij të investimeve publike për sektorin e transportit.

6. Përfituesi: (a) jo më vonë se 30 qershor 2007 paraqet strukturën e re të propozuar të GRD-së për rishikim dhe miratim nga Shoqata; dhe (b) jo më vonë se 30 qershori i vitit 2008 reformon GRD-në sipas strukturës së rënë dakord, në një mënyrë të pranueshme për Shoqatën.

### Seksioni III. Monitorimi i projektit, raportimi, vlerësimi

#### A. Raportet për projektin

1. Përfituesi monitoron dhe vlerëson progresin e projektit dhe përgatit raportet e projektit në pajtim me dispozitat e seksionit 4.08 të kushteve të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve që miratohen nga Shoqata. Çdo raport projekti mbulon periudhën e një semestri kalendarik, dhe i jepet Shoqatës jo më vonë se një muaj pas fundit të periudhës së mbuluar nga një raport i tillë.

2. Pa u kufizuar në dispozitat e paragrafit 1 të këtij nënseksioni, Përfituesi:

a) përgatit, në bazë të termave të referencës së Shoqatës, dhe i jep Shoqatës në ose rreth 15 majit të vitit 2009, një raport që përfshin rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit që kryhen në pajtim me paragrafin 1 të këtij nënseksioni, mbi progresin e bërë në realizimin e projektit gjatë periudhës para datës së raportit përkatës dhe cakton masat e rekomanduara për të siguruar kryerjen me efikasitet të projektit dhe arritjen e objektivave të tij gjatë periudhës pas kësaj date; dhe

b) rishikon me Shoqatën, rreth 15 majit të vitit 2009, ose në një datë të mëvonshme që mund të caktohet nga Shoqata, raportin e përmendur në paragrafin (a) të këtij nënseksioni, dhe pas kësaj,

merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përfundimin me efikasitet të projektit dhe arritjen e objektivave të tij, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raportit dhe mendimet e Shoqatës për çështjen.

#### B. Menaxhimi financiar, raportet dhe kontrollet financiare

1. Përfituesi mban ose merr masa për mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në pajtim me dispozitat e seksionit 4.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa u kufizuar në pjesën A të këtij seksioni, Përfituesi përgatit dhe i jep Shoqatës, jo më vonë se 45 ditë pas fundit të çdo semestri kalendarik, raporte financiare të ndërmjetme të paaudituarra për projektin që mbulojnë semestrin, në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën.

3. Përfituesit i auditohen deklaratimet e tij financiare në pajtim me dispozitat e seksionit 4.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i deklaratimeve financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Përfituesit, që fillon me vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e parë në bazë të projektit. Deklarimet e audituara financiare për çdo periudhë të tillë i jepen Shoqatës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të një periudhe të tillë.

#### Seksioni IV. Prokurimi

##### A. Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet. Të gjitha mallrat dhe punimet e kërkuara për projektin dhe që financohen nga të ardhurat e kredisë prokurohen në pajtim me kërkesat e parashikuara ose përmendura në seksionin I të udhëzimeve për prokurimet, dhe me dispozitat e këtij plani.

2. Shërbimet e konsulentit. Të gjitha shërbimet e konsulentit që kërkohen për projektin dhe që financohen nga të ardhurat e kredisë prokurohen në pajtim me kërkesat e parashikuara ose përmendura në seksionet I dhe IV të udhëzimeve për konsulentin dhe me dispozitat e këtij plani.

3. Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metoda rishikimi nga shoqata e kontratave të veçanta, i takojnë metodës përkatëse të përshkruar në udhëzimet për prokurimet, udhëzimet për konsulentët, sipas rastit.

##### B. Metoda të veçanta për prokurimin e mallrave dhe punimeve

1. Ftesa për ofertë konkurruese ndërkombëtare. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe punimet prokurohen në bazë të kontratave të dhëna mbi bazën e ftesave për oferta konkurruese ndërkombëtare.

2. Metoda të tjera për prokurimin e mallrave dhe punimeve. Tabela e mëposhtme përcakton metodat e prokurimit, të ndryshme nga ftesa për ofertë konkurruese ndërkombëtare, që mund të përdoret për mallrat dhe punët. Plani i prokurimit përcakton rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda.

Metoda e prokurimit
a) Ftesa për ofertë konkurruese kombëtare – me modifikimet e parashikuara në paragrafin 3 më poshtë
b) Blerje
c) Kontraktim i drejtpërdrejtë

3. Procedurat e ftesave për ofertë konkurruese kombëtare bazohen në procedurat e tenderimit të hapur sipas parashikimit të ligjit “Për prokurimin publik” në Shqipëri dhe dispozitatve të mëposhtme shtesë:

i) procedurat e “Tenderimit të hapur”, sipas përcaktimit të ligjit të prokurimit publik në Shqipëri, zbatohen në të gjitha kontratat.

ii) ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga dhënia e ofertës dhe nuk jepet asnjë lloj preference

për ofertuesit vendas në procesin e ofertave. Ndërmarrjet qeveritare në Shqipëri lejohet të japin ofertë vetëm nëse janë ligjërisht dhe financiarisht autonome dhe operojnë në bazë të ligjit tregtar të Përfituesit;

iii) subjektet prokuruese përdorin dokumente model për dhënien e ofertave të miratuara nga Shoqata;

iv) në rastin e çmimeve më të larta të ofertës krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk refuzohet pa pëlqimin paraprak të Shoqatës;

v) zbatohet një procedurë me një zarf të vetëm për paraqitjen e ofertave;

vi) kualifikimi pasues kryhet vetëm mbi ofertuesin më të ulët të vlerësuar; asnjë ofertë nuk refuzohet në momentin e hapjes së ofertave për shkaqe skualifikuese;

vii) ofertuesit që kontraktajnë si shoqëri e përbashkët mbajnë përgjegjësi të veçantë dhe solidare;

viii) kontratat i jepen ofertuesit më të ulët të vlerësuar, esencialisht përmbushës, që mendohet të jetë i kualifikuar për të punuar në pajtim me kriteret e paracaktuara dhe të treguara para vlerësimit;

ix) konsultimet pas ofertave nuk lejohen të kryhen me ofertuesin më të ulët të vlerësuar apo ndonjë tjetër; dhe

x) kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më shumë se 18 muaj) përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimeve.

C. Metodatat e veçanta për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve

1. Zgjedhja cilësore dhe bazuar mbi shpenzimet. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 të mëposhtëm, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes cilësore dhe bazuar mbi shpenzimet.

2. Metoda të tjera për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve. Tabela e mëposhtme përcakton metodat e prokurimit, të ndryshme nga përzgjedhja cilësore dhe bazuar mbi shpenzimet, që mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit përcakton rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda.

Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhja për shpenzimet më të ulta
b) Përzgjedhje bazuar mbi kualifikimet e konsulentëve
c) Konsulentë individualë
d) Buxhet fiks

D. Rishikimi nga banka i vendimeve të prokurimeve

1. Plani i prokurimeve cakton ato kontrata që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Shoqatës. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit pasues nga Shoqata.

Seksioni V. Tërheqja e të ardhurave të kredisë

A. Të përgjithshme

1. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat e kredisë në pajtim me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme, dispozitat e këtij seksioni dhe udhëzimet shtesë që përcaktohet nga Banka që i njoftohen Përfituesit për të financuar shpenzimet e përshtatshme të parashikuara në tabelën e paragrafit 2 të mëposhtëm.

2. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme që mund të financohen nga të ardhurat e kredisë (Kategoria), alokimi i shumave të kredisë për çdo kategori, dhe përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e përshtatshme në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e huasë së alokuar (shprehur në SDR)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1. Mallra	380 000	100%
2. Punime civile për pjesën I të	664 000	88%

projektit		
3. Punime civile për pjesën II të projektit	120 000	10%
4. Shërbimet e konsulentëve për pjesët I dhe II të projektit	350 000	20%
5. Shërbimet e konsulentëve për pjesët III dhe IV të projektit dhe trajnimit	1 720 000	100%
6. Shpenzimet operative të akumuluar	166 000	100%
SHUMA TOTALE	3.400. 000	

B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat e bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveçse tërheqjeve në lidhje me kategoritë (2), (4) dhe (5) për zbatimin e pjesës I dhe IV të projektit deri në një shumë të përgjithshme që nuk kalon barasvlerën SDR 680 000 që mund të bëhen për pagesat e bëra para kësaj date, por në ose pas 1 tetorit 2006.

2. Data e mbylljes është 30 qershor 2011.

PLANI 3  
PLANI I SHLYERJES

Data që pagesa është e kërkueshme	Shuma principale e kredisë së shlyeshme (shprehur në përqindje)*
Në çdo 15 maj dhe 15 nëntor	
Fillon më 15 maj, 2017 deri dhe duke përfshirë 15 nëntor 2026	5%

\*Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës principate të kredisë që duhet të shlyhet, përveç rasteve kur Shoqata mund të përcaktojë ndryshe në pajtim me seksionin 3.03(b) të kushteve të përgjithshme.

SHTOJCË

Përkufizime

1. “Kategori” është një kategori e parashikuar në tabelën e seksionit V të planit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. “Bashkëfinancues” është Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar.

3. “Bashkëfinancim” është shuma e pesëmbëdhjetë milion dollarëve (15 000 000 USD), që duhet të jepet nga bashkëfinancuesi për të ndihmuar në financimin e projektit.

4. “Marrëveshje bashkëfinancimi” është marrëveshja që lidhet ndërmjet Përfituesit dhe Bashkëfinancuesit që parashikon bashkëfinancimin.

5. “Udhëzimet e konsulentit” janë “Udhëzimet: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore” të publikuar nga Banka në maj 2004.

6. “Korridori i rrugës Durrës–Morinë” është rruga e propozuar e ndërtuar ndërmjet qyteteve të Durrësit dhe të Morinit në territorin e Përfituesit.

7. “Plani i menaxhimit të ambientit” është plani i miratuar nga Përfituesi më 3 janar 2006, që pranohet nga Shoqata, që përbëhet nga një grup masash për zbutjen, monitorimin dhe masat institucionale që duhet të merren për të eliminuar efektet negative mbi ambientin dhe shoqërinë, neutralizuar ose pakësuar në nivele të pranueshme, si dhe veprimet e nevojshme për të zbatuar këto masa.

8. “Njësi ambientaliste” është njësi ambientaliste brenda GRD-së (siç quhet këtu).

9. “Kushte të përgjithshme” janë “Kushtet e përgjithshme të Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar për kreditë dhe grantet”, të datës 1 korrik 2005.

10. “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve” ose “GRD” është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve brenda MPWTT-së (siç referohet këtu e tutje) dhe përfshin çdo pasues të saj.

11. “Shpenzime operative të akumuluar” janë shpenzimet e akumuluar të arsyeshme dhe të nevojshme, të miratuara nga Shoqata mbi bazën e buxheteve vjetore të pranueshme për Shoqatën, që shkaktohen nga GRD-ja dhe MPWTT-ja (siç referohen këtu e tutje) për llogari të zbatimit, menaxhimit dhe monitorimit të projektit, duke përfshirë shpenzimet dhe shpenzimet e komunikimit, korrierit ose postës, shpenzimet e përkthimit dhe interpretimit, tarifatat bankare dhe shpenzime të tjera të ndryshme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit, siç mund të bihet dakord me Shoqatën, por duke përjashtuar pagat ose honoraret e nëpunësve dhe punonjësit e shërbimit publik të Përfituesit, duke përfshirë GRD-në dhe MPWTT-në (siç referohet këtu e tutje).

12. “Seksioni Milot-Rrëshen i korridorit të rrugës Durrës-Morinë” është seksioni i propozuar i rrugës së ndërtuar ndërmjet qyteteve Milot dhe Rrëshen në territorin e Përfituesit.

13. “Ministria e Financave” ose “MoF” është Ministria e Financave e Përfituesit dhe përfshin çdo pasues të saj.

14. “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” ose “MPWTT” është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Telekomunikacionit e Përfituesit dhe përfshin çdo pasues të saj.

15. “Plani kombëtar i veprimit” është plani i veprimit për sigurinë në rrugë, i përgatitur dhe i miratuar nga Këshilli i Sigurisë në Rrugë (siç referohet këtu e tutje) më 15 mars 2006, në pajtim me urdhrin nr.44 të Kryeministrit të Përfituesit.

16. “Plani për zbatimin e projektit” është dokumenti që i referohet seksionit II.I të planit 2 të kësaj Marrëveshjeje, të miratuar nga Përfituesi me 12 dhjetor, 2006, të pranueshme për Shoqatën, që përcakton procedurat e menaxhimit financiar dhe masat institucionale për kryerjen e projektit, ku ky mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Shoqatës dhe Përfituesit.

17. “Ekipi i zbatimit të projektit” ose “PIT” është ekipi i zbatimit të projektit brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

18. “Udhëzimet e prokurimeve” janë “Udhëzimet për prokurimin brenda huasë së IBRD-së dhe kredive të IDA-s, botuar nga Banka në maj të vitit 2004.

19. “Programi i investimeve publike” është programi i Përfituesit i përgatitur si pjesë e Programit të Buxhetimit Afatmesëm të Qeverisë së Përfituesit, dhe nxjerr një vlerësim realist të shpenzimeve kapitale të propozuara nga Qeveria e Përfituesit dhe burimi i financimit, për afatin e përcaktuar të programit.

20. “Plani i prokurimit” është plani i prokurimit të Përfituesit për projektin të datës 12 dhjetor 2006 dhe të përmendur në paragrafin 1.16 të udhëzimeve të prokurimeve dhe paragrafin 1.24 të udhëzimeve të konsulentit, siç mund të ndryshohet herë as here në pajtim me dispozitat këtyre paragrafëve.

21. “Ligji i prokurimit publik në Shqipëri” është ligji i Përfituesit nr.7971, datë 26 korrik 1995, i ndryshuar së fundi me ndryshimin nr.9372, datë 14 prill 2005.

22. “Plani i veprimit për rivendosjen” është plani i veprimit për rivendosjen i përgatitur nga Përfituesi dhe i miratuar më 4 qershor 2006, i pranueshëm për Shoqatën, që cakton procedurat, veprimet dhe politikat për vlerësimin, zbutjen dhe monitorimin e rivendosjes që rrjedh nga aktivitetet e kryera sipas këtij projekti, dhe ky mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe Shoqatës.

23. “Këshilli i Sigurisë në Rrugë” është subjekti i Përfituesit i ngarkuar me mbikëqyrjen e sigurisë në rrugë, të ngritur më 25 janar 2006, në pajtim me urdhrin nr 13, të Kryeministrit të Përfituesit.

24. “Trajnim” janë aktivitetet e trajnimit (të ndryshme nga shërbimet e konsulentëve) që kryhen në bazë të projektit, siç miratohen nga Shoqata mbi bazën e trajnimit vjetor dhe planeve të tureve studimore të pranueshme për Shoqatën, duke përfshirë shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme lokale dhe ndërkombëtare të udhëtimit dhe të vizave të shkaktuara nga pjesëmarrësit në seminarët e trajnimit dhe turet studimore, si dhe strehimi, ushqimi, dietat lokale dhe ndërkombëtare, regjistrimi, tarifatat e mësimdhënies dhe trajnuesve, shpenzimet dytësore organizative (duke përfshirë shpenzimet e pajisjeve, materialeve që shpërndahen dhe të trajnimit), shpenzimet e përkthimit dhe

interpretimit, shpenzimet e qirasë së ambienteve, shpenzime të tjera që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me seminarët e trajnimit dhe aktivitetin e tureve studimore, që pranohen nga Shoqata.

**LIGJ**  
**Nr.9729, datë 10.5.2007**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE  
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E TRANSPORTIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e transportit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5326, datë 22.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE HUAJE**  
**(PROJEKT TRANSPORTI) NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS**  
**NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**  
Datë \_\_\_\_\_, 2006

Marrëveshje e datës \_\_\_\_, 2006 ndërmjet Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

*ndërsa Huamarrësi i ka kërkuar Shoqatës të japë asistencë shtesë për financimin e projektit dhe me një marrëveshje me datë të njëjtë ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës (Marrëveshja e financimit), Shoqata bie dakord ta japë një asistencë të tillë në një shumë principale të plotë të barabartë me tre milionë e katërqind mijë të drejta të veçanta tërheqjeje (SDR 3 400 000) (Kredia).*

Neni 1

**Kushte të përgjithshme, përkufizime**

1.01 Kushtet e përgjithshme (sipas përcaktimit në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa të mëdha të përdorura në Marrëveshjen e huasë kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet e përgjithshme, në Marrëveshjen e financimit, ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 2 **Huaja**

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, me termat dhe kushtet e përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën e pesëmbëdhjetë milionë e treqind mijë euro (15 300 000 euro) për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në planin 1 të Marrëveshjes së financimit (Projekti).

2.02. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat nga huaja në pajtim me planin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03. Tarifa e angazhimit që paguhet nga Huamarrësi është e barabartë me tre të katërtat e njëpërqindëshit (3/4 e 1%) në vit mbi bilancin e huasë së patërhequr, që i nënshtrohet heqjes dorë nga një pjesë e kësaj tarife që mund të caktohet nga Banka herë pas here.

2.04 Tarifa fillestare që paguhet nga Huamarrësi është e barabartë me një për qind (1.0%) të shumës së huasë, që i nënshtrohet heqjes dorë nga një pjesë e një tarife të tillë që mund të caktohet nga Banka herë pas here.

2.05 Interesi që paguhet nga Huamarrësi për periudhën e interesit është në një shkallë të barabartë me LIBOR-in për monedhën e huasë plus shtrirjen variabël, që i nënshtrohet heqjes dorë nga një pjesë e një tarife të tillë që mund të caktohet nga Banka herë pas here.

2.06 Datat e pagesës janë 15 maji dhe 15 nëntori i çdo viti.

2.07 Shuma principale e huasë shlyhet në pajtim me planin e amortizimit të parashikuar në planin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 3 **Projekti**

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi, me anë të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, zbaton projektin në pajtim me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme.

3.02 (a) Në pajtim me paragrafin (b) të këtij seksioni, seksioni 3.02 i Marrëveshjes së financimit dhe planet 1 dhe 2 të saj, përveç seksionit V të planit 2, janë përfshirë në Marrëveshjen e huasë, me modifikimet e mëposhtme në seksionet dhe planet përkatëse, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

i) termi “Shoqatë” kuptohet si “Bankë”;

ii) termi “Përfitues” kuptohet si “Huamarrës”;

iii) termi “Kredi” kuptohet si “Hua”; dhe

iv) termat “kjo Marrëveshje” ose “Marrëveshja e financimit” kuptohen si “Marrëveshje huaje”.

b) Nëse Huamarrësi nuk njoftohet ndryshe nga Banka:

i) të gjitha veprimet e ndërmarra, duke përfshirë miratimet e dhëna, nga Shoqata në pajtim me një nga seksionet dhe planet e Marrëveshjes së financimit të renditura në paragrafin (a) të këtij seksioni, si dhe në pajtim me seksionin 2.02 të Marrëveshjes së financimit, mendohet të merret në emër dhe për llogari të Shoqatës dhe Bankës; dhe

ii) i gjithë informacioni dhe dokumentimi i dhënë nga Huamarrësi Shoqatës në pajtim me



dispozitat e një prej këtyre seksioneve të Marrëveshjes së financimit ose planeve të saj mendohet t'i jenë dhënë Shoqatës dhe Bankës.

#### Neni 4

#### **Hyrja në fuqi, prishja**

4.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen sa më poshtë:

a) Marrëveshja e financimit është përfunduar dhe dorëzuar dhe të gjitha kushtet para hyrjes së saj në fuqi janë përmbushur, të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje.

b) Marrëveshja e bashkëfinancimit është përfunduar dhe dorëzuar dhe të gjitha kushtet para hyrjes në fuqi të saj ose të drejtës së Përfituesit për të bërë tërheqje në bazë të saj (të ndryshme nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së financimit dhe huasë) janë përmbushur.

4.02 Afati i fundit i hyrjes në fuqi është data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 5

#### **Përfaqësuesi, adresat**

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave.

5.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri

Faks +355 42 28 494

5.03 Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Adresa Kablllore

INTBAFRAD

Washington, D.C.,

Teleks

248423(MCI) ose

64145 (MCI)

Faks

1-202-477-6391

rënë dakord më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, në ditën dhe vitin të shkruar më sipër

Shqipëri

Nga \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i autorizuar

Banka Ndërkombëtare për

Rindërtim dhe Zhvillim

Nga \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i autorizuar

**PLANI 1**  
**TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË HUASË**

**A. Të përgjithshme**

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huasë në pajtim me dispozitat e këtij seksioni dhe udhëzimet shtesë që përcaktohen nga Banka që i njoftohen Huamarrësit për të financuar shpenzimet e përshtatshme të parashikuara në tabelën e paragrafit 2 të mëposhtëm.

2. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme që mund të financohen nga të ardhurat e huasë (Kategoria), alokimi i shumave të huasë për çdo kategori, dhe përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e përshtatshme në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e huasë së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financiar
1. Punime civile për pjesën I të projektit	14 826 000	88 %
2. Punime civile për pjesën II të projektit	472 000	10 %
3. Shërbime konsulence për pjesët I dhe II të projektit	1000	20 %
4. Shërbimet e konsulentëve për pjesët III dhe IV të projektit	1000	100 %
5. Tarifa fillestare	0	Shuma e pagueshme në pajtim me seksionin 2.04 të kësaj Marrëveshjeje në pajtim me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
<b>SHUMA TOTALE</b>	<b>15 300 000</b>	

**B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes**

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat e bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveçse tërheqjeve në lidhje me kategorinë (1) për zbatimin e pjesës I të projektit deri në një shumë të përgjithshme që nuk kalon barasvlerën 3 046 000 euro mund të bëhen për pagesat e bëra para kësaj date, por në dhe pas 1 tetorit 2006.

2. Data e mbylljes është 30 qershor 2011.

**PLANI 2**  
**PLANI I AMORTIZIMIT**

Data e pagesës së principalit	Shuma principale e huasë së pagueshme (shprehur në euro)
nëntor 15, 2011	460 000
maj 15, 2012	470 000

nëntor 15, 2012	475 000
maj 15, 2013	485 000
nëntor 15, 2013	495 000
maj 15, 2014	505 000
nëntor 15, 2014	515 000
maj 15, 2015	525 000
nëntor 15, 2015	535 000
maj 15, 2016	545 000
nëntor 15, 2016	555 000
maj 15, 2017	565 000
nëntor 15, 2017	575 000
maj 15, 2018	590 000
nëntor 15, 2018	600 000
maj 15, 2019	610 000
nëntor 15, 2019	625 000
maj 15, 2020	635 000
nëntor 15, 2020	645 000
maj 15, 2021	660 000
nëntor 15, 2021	670 000
maj 15, 2022	685 000
nëntor 15, 2022	700 000
maj 15, 2023	710 000
nëntor 15, 2023	725 000
maj 15, 2024	740 000

## SHTOJCË

### Përkufizime

1. “Kategori” është një kategori e përcaktuar në tabelën e planit 1 të kësaj Marrëveshjeje.
2. “Marrëveshje financimi” është marrëveshja ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës për projektin, të së njëjtës datë si Marrëveshja e huasë, siç mund të ndryshohet kjo marrëveshje herë pas here. “Marrëveshja e financimit” përfshin të gjithë shtojcat, planet dhe marrëveshjet shtesë të Marrëveshjes së financimit.
3. “Kushte të përgjithshme” janë “Kushtet e përgjithshme për huatë e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, të datës 1 korrik, 2005.

## LIGJ

Nr.9730, datë 10.5.2007

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E ADMINISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË TOKËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e administrimit dhe menaxhimit të tokës".

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5327, datë 22.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

### **MARRËVESHJE FINANCIMI**

(PROJEKTI I MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË TOKËS) NDËRMJET SHQIPËRISË  
DHE SHOQËRISË NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Datë \_\_\_\_\_, 2006

Marrëveshje e datës \_\_\_\_\_, 200\_, ndërmjet Shqipërisë (Përfituesi) dhe Shoqërisë Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqëria). Përfituesi dhe Shoqëria nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

*duke pasur parasysh që* Përfituesi i ka kërkuar gjithashtu Bankës të sigurojë ndihmë shtesë mbi financimin e projektit dhe në këtë mënyrë sipas marrëveshjes të së njëjtës datë ndërmjet Përfituesit dhe Bankës (Marrëveshja e huasë), Banka bie dakord t'i sigurojë një ndihmë të tillë në një shumë totale të barasvlershme me pesëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë euro (15,200,000 euro) (Huaja).

## Neni 1

### **Dispozita të përgjithshme, përcaktime**

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Vetëm në rast se konteksti e kërkon ndryshe, terminologjia e Marrëveshjes së financimit mbart kuptime të atribuara nga dispozitat e përgjithshme ose nga shtojca e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 2

### **Financimi**

2.01 Shoqëria bie dakord t'i siguroj Përfituesit, sipas kushteve të përcaktuara ose përmendura në këtë Marrëveshje, një kredi të tipit *Special Drawing Right* të barasvlershme me dhjetë milionë (10,000,000 SDR) (Kredi) për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në pasqyrën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat nga kredia në përputhje me seksionin V të pasqyrës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Maksimumi i normës së disponueshmërisë së shumës/*commitment charge* për t'u paguar nga ana e Përfituesit mbi bilancin e kredisë së pa tërhequr është gjysmë për qind (1/2 e 1%) në vit.

2.04 Tarifa e shërbimit për t'u paguar nga ana e Përfituesit mbi bilancin e kredisë së tërhequr është tre të katërtat e njëpërqindëshit (3/4 të 1%) në vit.

2.05 Datat e pagesës janë 15 maji dhe 15 nëntori i çdo viti.

2.06 Shuma e principalit të kredisë shlyhet në përputhje me planin e shlyerjes të përcaktuar në pasqyrën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Monedha e pagesës është në euro.

Neni 3  
**Projekti**

3.01 Përfituesi deklaron përkushtimin e tij kundrejt objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi nëpërmjet Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Patundshme (ZRPP), Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) dhe Ministrisë së Brendshme, realizon projektin në përputhje me dispozitat e nenit IV të kushteve të përgjithshme.

3.02 Pa kufizuar dispozitat e pikës 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç rasteve kur Përfituesi dhe Shoqëria bien dakord ndryshe, Përfituesi garanton që projekti realizohet në përputhje me dispozitat e pasqyrës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4  
**Kompensimi i Shoqërisë**

4.01 Rastet shtesë të pezullimit konsistojnë si më poshtë vijon:

i) Kushtëzuar nga nënparagrafi (ii) i këtij paragrafi, e drejta e Përfituesit për të tërhequr të ardhurat respektive të grantit të bashkëfinancuar Suedez ose të grantit të bashkëfinancuar Japonez të jetë pezulluar, anuluar ose përfunduar pjesërisht ose plotësisht sipas kushteve të Marrëveshjes së bashkëfinancimit Suedez ose Marrëveshjes së bashkëfinancimit Japonez.

ii) Nënparagrafi (i) i këtij paragrafi nuk zbatohet nëse Përfituesi arrin të bind Shoqërinë se:

A. pezullime, anulime, ose përfundime të tilla nuk janë pasojë e dështimit të Përfituesit për të realizuar ndonjë nga detyrimet e tij respektivisht sipas Marrëveshjes së grantit të bashkëfinancimit Suedez ose Marrëveshjes së grantit të bashkëfinancimit Japonez; dhe

B. fonde të mjaftueshme për projektin janë në dispozicion të Përfituesit nga burime të tjera me afate dhe kushte në përputhje me detyrimet e Përfituesit sipas Marrëveshjes së grantit të bashkëfinancimit Suedez ose Marrëveshjes së grantit të bashkëfinancimit Japonez.

Neni 5  
**Efektshmëria, kohëzgjatja**

5.01 Kushtet shtesë të efektshmërisë konsistojnë si më poshtë vijon:

a) Marrëveshja e Kredisë realizohet, dorëzohet dhe të gjitha kushtet me precedencë të efektshmërisë janë plotësuar përveç atyre që kanë të bëjnë me efektshmërinë e kësaj Marrëveshjeje;

b) Marrëveshja e grantit të bashkëfinancimit Suedez dhe Marrëveshja e grantit të bashkëfinancimit Japonez janë realizuar, dorëzuar dhe të gjitha kushtet me precedencë të efektshmërisë së tyre respektive ose të së drejtës të Përfituesit për të kryer tërheqje sipas Marrëveshjes së grantit të bashkëfinancimit Suedez ose Marrëveshjes së grantit të bashkëfinancimit Japonez (përveç efektshmërisë së Marrëveshjes së financimit dhe kredisë) janë plotësuar; dhe

c) Manuali operacional i projektit dhe manuali i menaxhimit financiar janë miratuar nga Përfituesi.

5.02 Afati i fundit i efektshmërisë është përmbushja e nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6  
**Përfaqësuesi, adresat**

6.01 Përfaqësuesi i Përfituesit është Ministria e Financave.

6.02 Adresa e Përfituesit:

Ministry of Finance  
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”  
Tirana, Albania  
Faks

+355 42 28494

6.03 Adresa e Shoqërisë:  
International Development Association  
1818 H Street. N.W  
Washington, D.C. 20433  
United States of America

Telegraf:                      Teleks:                      Faks:  
INDEVAS                      248423 (MCI) ose                      1-202-477-6391  
Washington, D.C                      64145 (MCI)

Lidhur më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, ditën dhe vitin e mësipërm.

Shqipëri

Nga \_\_\_\_\_  
Përfaqësues i autorizuar

Për Shoqërinë Ndërkombëtare për Zhvillim

Nga \_\_\_\_\_  
Përfaqësuesi i autorizuar

## PASQYRA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është përmirësimi i efikasitetit dhe efektshmërisë të administrimit të tokës dhe menaxhimit urban me anë të rritjes së sigurisë së pronësisë, përmirësimi të planifikimit urban, menaxhimit të tokës dhe zhvillimit të kontrollit, përmirësimi të vlerësimit të pasurisë dhe vënies së taksave dhe investimeve në infrastrukturën dhe shërbimet urbane.

Projekti konsiston në ndarjet e mëposhtme, të ndryshueshme herë pas here sipas rënies dakord të Përfituesit dhe Shoqërisë për të arritur objektivin përkatës:

Pjesa A. Sigurimi i pronësisë dhe regjistrimi i të drejtave të pasurisë së patundshme

1. Përmirësimi i shërbimit të ofruar nga ZRPP për regjistrimin e tokës dhe transaksioneve të pasurisë me anë të sigurimit të pajisjeve dhe orendive, shërbimeve konsulente e teknike, teknologjisë së informacionit, shërbimit të kualifikimit dhe ngritjes së kapaciteteve.

2. Mbështetje operationale për plotësimin e regjistrimit të parë të pasurisë së patundshme urbane, ndërurbane dhe rurale, përfshirë, ndër të tjera, informimin publik dhe fushata ..., shërbime të përpilimit të hartave dhe juridike, mbështetje mbi kontrollin e cilësisë, me anë të sigurimit të materialeve, shërbimeve teknike dhe konsulente.

3. Zhvillimi dhe rishikimi i ligjshmërisë dhe rregulloreve të nevojshme për të mbështetur plotësimin e regjistrimit të pasurisë së patundshme, përmirësimin e shërbimeve të ZRPP dhe rritjes së sigurisë pronësisë me anë të sigurimit të shërbimeve konsulente.

4. Zhvillimi i një vlerësimi mbi nevojat për kualifikim, sigurimi i kualifikimit për stafin e ZRPP, dhe krijimin e një qendre kualifikimi në zyrat qendrore të ZRPP me anë të sigurimit të shërbimeve konsulente, kualifikimit, mallrave dhe punimeve.

5. Forcimi i kapaciteteve administrative, menaxhuese të projektit dhe në përgjithësi të ZRPP me anë të përbalimit të koston operationale shtesë, pajisjeve, dhe shërbimeve konsulente.

Pjesa B. Menaxhimi i tokës urbane

1. Ngritja e kapaciteteve në bashkitë pjesëmarrëse, përfshirë, ndër të tjera, zhvillimin e planeve rregulluese, krijimin e sistemeve kompjuterik të vlerësimit, dhe implementimit të sistemit të adresave me anë të sigurimit të shërbimeve konsulente, teknike dhe materialeve të nevojshme.

2. Përgatitja e një ligji mbi përcaktimin e vlerës së pasurisë dhe futjen e vënies së taksës së pasurisë mbi bazën e vlerës së tregut në bashkitë pjesëmarrëse.

3. Zhvillimi i ligjshmërisë dhe rregulloreve të menaxhimit të tokës urbane me anë të sigurimit të shërbimeve konsulente.

4. Sigurimi i kualifikimit për stafin bashkiak mbi planifikimin e përdorimit të tokës dhe zhvillimit të kontrollit.

5. Forcimi i kapaciteteve menaxhuese dhe administrative të Departamentit të Planifikimit Urban me anë të përballimit të kostos operacionale shtesë, sigurimit të materialeve dhe shërbimeve konsulente.

Pjesa C. Infrastruktura bashkiake

1. Sigurimi i granteve të vogla për bashkitë pjesëmarrëse për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet bashkiake.

2. Implementimi i sistemit të adresave në bashkitë pjesëmarrëse nëpërmjet sigurimit të bazës materiale dhe shërbimeve konsulente.

3. Sigurimi i kualifikimit për bashkitë pjesëmarrëse në fushën e prokurimit dhe menaxhimit financiar.

4. Menaxhimi i projektit dhe mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të Ministrisë së Brendshme me anë të përballimit të kostos operacionale shtesë, sigurimit të bazës materiale dhe shërbimeve konsulente.

## PASQYRA 2 ZBATIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Përgatitjet institucionale

Përfituesi realizon projektin në përputhje me mekanizmat e mëposhtëm të kordinimit:

1. ZRPP është përgjegjëse për realizimin e pjesës A të projektit. Si e tillë, ZRPP, është, ndër të tjera, përgjegjëse për prokurimin, menaxhimin financiar, planifikimin, kordinimin e monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të pjesës A të projektit. Kryesekretari i ZRPP drejton i pjesës A të projektit.

2. Departamenti i Planifikimit Urban në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është përgjegjës për realizimin e pjesës B të projektit. Si e tillë, Ministria e Punëve Publike, ndër të tjera, është përgjegjëse për prokurimin, menaxhimin financiar si dhe monitorimin dhe raportimin për pjesën B të projektit. Kryetari i Departamentit të Planifikimit Urban në Ministrinë e Punëve Publike drejton pjesën B të projektit.

3. Departamenti i Financimit të Qeverisjes Vendore në Ministrinë e Brendshme është përgjegjës për realizimin e pjesës C të projektit. Si i tillë, Ministria e Brendshme, ndër të tjera, është përgjegjëse për prokurimin, menaxhimin financiar, planifikimin, kordinimin e monitorimin dhe për çështjet sociale dhe mjedisore të aktiviteteve të kryera në pjesën C të projektit. Bashkitë pjesëmarrëse mbaj përgjegjësi për realizimin e aktiviteteve ditore të pjesës C1 të projektit. Kryetari i Departamentit për Financimin e Qeverisjes Vendore në Ministrinë e Brendshme drejton pjesën C të projektit. Ministria e Brendshme kryen kontrole operacionale të Granteve të vogla në bashkitë pjesëmarrëse për pjesën C1 të projektit në përputhje me dispozitat e manualit operacional të projektit.

4. Komiteti Drejtues i Projektit është përgjegjës për kordinimin e pjesëve A, B dhe C të projektit. Ai kryesohet nga Ministri i Drejtësisë ose nga një person i emëruar prej tij dhe përfshinë anëtarë nga Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Brendshme, Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Patundshme dhe Drejtorin Ekzekutiv të Shoqatës Bashkiake Shqiptare.

5. Përfituesi garanton se, gjatë gjithë kohës së realizimit të projektit, Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Patundshme, Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Brendshme përkushtohen dhe punësojnë staf, përfshirë prokurimin dhe specialistë të menaxhimit financiar, dhe burime e duhura për implementimin e projektit.

Seksioni II. Marrëveshje implementimi

1. Përfituesi zbaton projektin në përputhje me strukturën e politikës ambientaliste dhe strukturën e politikës së risistemimit, manualin operacional të projektit, dhe manualin e menaxhimit financiar dhe nuk ndryshon, pezullon, shfuqizon, dhe heq dorë nga ndonjë nga dispozitat e strukturës së politikës ambientaliste dhe strukturës së politikës së risistemimit, manualit operacional

të projektit, dhe manualit të menaxhimit financiar pa miratimin paraprak të Shoqërisë.

## 2. Përfituesi:

a) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për dorëzimin në Parlament: (i) brenda datës 30 shtator 2007 të një ligji të përmirësuar mbi menaxhimin urban, dhe (ii) brenda 15 majit 2008 të një projekt ligji mbi vlerësimin e pasurisë, të dy në mënyrë të pranueshme nga ana e Shoqërisë.

b) jo më vonë se 1 janari 2009, riorganizon Zyrën e Drejtave të Pasurisë së Patundshme si organ autonom dhe vetëfinancues, kryesuar nga një kryesekretar i cili i raporton një bordi drejtorësh të përbërë nga përfaqësues të qeverisë së Përfituesit dhe grupeve të interesit; dhe

c) jo më vonë se 31 dhjetor 2008, krijon një politikë dhe ndërmerr masa rregullatore dhe masa të tjera për mbrojtjen e të drejtave të sanksionuara të pasurisë në mënyrë të pranueshme nga Shoqëria.

3. Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, realizon dy inspektime operacionale dhe auditime financiare të aktiviteteve të ndërmarra në pjesën C1 të projektit për t'u shqyrtuar nga Shoqëria në përputhje me kushtet e përcaktuara në manualin operacional të projektit.

## Seksioni III. Monitorimi i projektit, raportimi, vlerësimi

### A. Raportet mbi projektin

1. Përfituesi monitoron dhe vlerëson progresin e projektit dhe përgatit raporte mbi projektin në përputhje me dispozitat e seksionit 4.08 të dispozitave të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të rënë dakord me Shoqërinë. Çdo raport mbi projektin përfshin periudhën kalendarike të një semestri dhe dorëzohet respektivisht brenda datës 30 shtator dhe 31 mars duke filluar nga data 31 mars 2007.

2. Pa kufizuar dispozitat e paragrafit 1 të këtij nënseksioni, Përfituesi:

a) përgatit, sipas kushteve të përcaktuara në mënyrë të pranueshme për Shoqërinë, dhe i paraqet Shoqërisë, në ose rreth datës 31 mars 2009 një raport ku njësohen rezultatet e monitorimit dhe aktivitetet vlerësuese të realizuara në vijim të paragrafit (1) të këtij nënseksioni mbi progresin e arritur në zbatimin e projektit gjatë periudhës që paraprin datën e raportit në fjalë dhe përcaktuar masa rekomanduese për të siguruar realizimin efikas të projektit dhe arritjen e objektivave që dalin gjatë periudhës që pasojnë një datë të tillë; dhe

b) shqyrton me Shoqërinë, brenda datës 30 prill 2009, ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar prej saj, raportin e përmendur në paragrafin (a) të këtij nënseksioni, dhe, pas kësaj, merr të gjitha masat e duhura për të siguruar një përfundim të efektshëm të projektit dhe përmbushjen e objektivave përkatëse bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit në fjalë dhe pikëpamjet e Shoqërisë mbi çështjen.

### B. Menaxhimi financiar, raportet dhe auditimet financiare

1. Përfituesi mban ose krijon një sistem menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 4.09 të dispozitave të përgjithshme.

2. Pa kufizuar dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, Përfituesi përgatit dhe i dorëzon Shoqërisë jo më vonë se 45 ditë nga përfundimi i çdo tremujori kalendarik raporte financiare të përkohshme të pa audituara mbi projektin që mbulon tremujorin në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqërinë.

3. Përfituesi auditon deklaratimet e tij financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 4.09 (b) të dispozitave të përgjithshme. Çdo auditim i deklaratimeve financiare mbulon një periudhë fiskale një vjeçare të Përfituesit duke filluar me vitin fiskal në të cilin tërheqja e parë u realizua sipas projektit. Deklarimet financiare të audituara të çdo periudhe të tillë i paraqiten Shoqërisë jo më vonë se gjashtë (6) muaj mbas përfundimit të periudhës përkatëse.

## Seksioni IV. Prokurimi

### A. Të përgjithshme

1. Baza materiale dhe punimet. E gjithë baza materiale dhe punimet e nevojshme të projektit që do të financohen me të ardhurat e kredisë prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara apo përmendura në seksionin I të udhëzimeve prokuroese dhe dispozitat e kësaj pasqyre.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të nevojshme për projektin që do të financohen nga të ardhurat e kredisë prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara apo përmendura në seksionin I dhe IV të udhëzimeve konsulente dhe dispozitave të kësaj pasqyre.



3. Përcaktime. Terminologjia e përdorur më poshtë në këtë Seksion për të përshkruar metoda prokurimi të veçanta ose metoda shqyrtimi të kontratave të veçanta nga ana e Shoqërisë i referohen metodës korresponduese të përshkruar në udhëzimet e prokurimit dhe konsultimit sipas paraqitjes së rastit.

B. Metoda të veçanta prokurimi të bazës materiale dhe punimeve

1. Oferta konkurruese ndërkombëtare. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në paragrafin 2 të mëposhtëm, baza materiale dhe punimet prokurohen në bazë të kontratave të akorduara sipas ofertave konkurruese ndërkombëtare.

2. Metoda të tjera prokurimi të bazës materiale dhe punimeve. Tabela e mëposhtme specifikon metodat e prokurimit, të ndryshme nga ofertat konkurruese ndërkombëtare, të cilat mund të përdoren për bazë materiale dhe punime. Plani i prokurimit specifikon rrethanat sipas të cilave metoda të tilla mund të përdoren:

Metoda e prokurimit
a) Oferta konkurruese kombëtare- me modifikimet e përcaktuara në paragrafin 3 të mëposhtëm
b) Blerje
c) Kontakt i drejtpërdrejtë

3. Procedurat e ofertave konkurruese kombëtare bazohen në procedurat e tenderit të hapura sipas përcaktimeve të ligjit të prokurimeve publike të Shqipërisë dhe dispozitave shtesë të mëposhtme:

i) Procedurat e “Tenderit të hapur” sipas përcaktimeve të ligjit të prokurimeve publike të Shqipërisë zbatohen në çdo kontratë;

ii) Ofruesit e huaj nuk pengohen për të paraqitur oferta dhe asnjë preferencë e çfarëdo lloji nuk ju jepet ofruesve vendas në procesin e paraqitjes së ofertave. Sipërmarrjet shtetërore në Shqipëri lejohen të bëjnë oferta nëse ato janë ligjërish dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Përfituesit.;

iii) Entet prokuruese përdorin dokumente model për ofertë të miratuara nga Shoqëria;

iv) Në rastin e ofertave më të larta në krahasim me vlerësimet zyrtare, të gjitha ofertat nuk refuzohen pa pëlqimin paraprak të Shoqërisë;

v) Procedura e një zarfi të vetëm zbatohet për dorëzimin e ofertave;

vi) Paskualifikimi zbatohet vetëm me ofruesin e vlerësuar me ofertën më të ulët; asnjë ofertë nuk refuzohet në kohën e hapjes së ofertave për arsye kualifikimi;

vii) Ofruesit që kontraktajnë si “*joint venture*” konsiderohen të përbashkët dhe mbartin përgjegjësi më vete;

viii) Kontratat i akordohen ofertave të vlerësuara më të ulta, kryesisht ofruesve të cilët janë të vendosur të kualifikohen për të vepruar në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe të njohura të vlerësimit;

ix) Negociata pas tenderit me ofruesin e ofertës më të ulët ose me ofrues të tjerë nuk lejohen; dhe

x) Kontratat afatgjatë (më shumë se 18 muaj) përmbajnë dispozita e duhura për përshtatjen e çmimit.

C. Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Cilësia dhe përzgjedhja mbi bazën e kostos. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në paragrafin 2 të mëposhtëm, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të akorduara mbi bazën e cilësisë dhe përzgjedhjes mbi bazën e kostos.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Tabela e mëposhtme specifikon metodat e prokurimit, përveç metodës së cilësisë dhe përzgjedhjes mbi bazën e kostos, të cilat mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit specifikon rrethanat sipas të cilave metodat në fjalë përdoren.

Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhja e bazuar mbi kualifikimin e konsulentëve
b) Buxheti fiks
c) Konsulentë individual
d) Përzgjedhja me koston më të ulët
e) Përzgjedhja mbi një burim të vetëm

D. Shqyrtimi i vendimeve të prokurimit nga ana e Shoqërisë

1. Plani prokurimit përcakton kontratat të cilat i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga ana e Shoqërisë. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen shqyrtimit të mëvonshëm nga ana e Shoqërisë.

Seksioni V. Tërheqja e të ardhurave nga kredia

A. Të përgjithshme

1. Përfituesi mund të tërheq të ardhurat nga kredia në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme, dispozitave të këtij seksioni, dhe udhëzimeve përkatëse shtesë të specifikuara nga Banka me anë të njoftimit të Përfituesit për të financuar shpenzimet e pranueshme të përcaktuara në tabelën e paragrafit 2 të mëposhtëm.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme të cilat mund të financohen me anë të të ardhurave të kredisë (Kategori), akordimin e shumave të kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohet si shpenzime të pranueshme në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e kredisë së akorduar (shprehur në SDR/special <i>Drawing Right</i> )	Përqindjet e shpenzimeve që do të financohen
1. Baza materiale dhe punime për pjesën B të projektit	650,000	100%
2. Shërbimet e konsulentëve, kualifikimi, shërbimet teknike dhe kostot operacionale shtesë për pjesën A të projektit	8,090,000	100%
3. Shërbimet e konsulentëve, kualifikimi, shërbimet teknike dhe kostot operacionale shtesë për pjesën B të projektit	1,060,000	100%
4. Kompensimi i paradhënies të përgatitjes së projektit	200,000	Shuma që do të paguhet në vijim të seksionit 2.07 të dispozitave të përgjithshme

Shuma totale 10,000,000

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk kryhet për pagesa të realizuara para datës së kësaj Marrëveshjeje përjashtoj tërheqjet që i takojnë kategorive (2) dhe (3) deri në një shumë totale që nuk e kalon ekuivalentin e 400,000 SDR/special *Drawing Right* të cilat mund të kryhen për pagesa të realizuara para kësaj date por në ose mbas 1 janarit 2007.

2. Data e mbylljes është 31 dhjetori 2011.

**PASQYRA 3**  
**PLANI I SHLYERJES**

Data e caktuar për shlyerje	Shuma principale e kredisë për t'u shlyer (shprehur në përqindje)*
Çdo 15 maj dhe 15 nëntor	
Duke filluar nga 15 maji 2017 deri në dhe përfshirë 15 nëntorin 2026	5%

\*Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës principale të kredisë për t'u shlyer, përveç rasteve kur Shoqëria mund ta përcaktoj ndryshe në vijim të seksionit 3.03 (b) të dispozitave të përgjithshme.

**SHTOJCË**

**Përcaktime**

1. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në seksionin V të pasqyrës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. “Udhëzime konsulente” nënkupton “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore” botuar nga Banka në maj 2004.

3. “Departamenti i financimit të qeverisjes vendore” nënkupton departamentin përgjegjës për financimin e qeverisjes vendore në Ministrinë e Brendshme (siç është përcaktuar më poshtë).

4. “Strukturë e politikës ambientaliste” nënkupton strukturën e miratuar nga Përfituesi më 1 shtator 2006 në mënyrë të pranueshme nga ana e Shoqërisë që konsiston në një paketë masash lehtësuese, monitoruese dhe institucionale që do të ndërmerren për të eliminuar ndikimet e pafavorshme sociale dhe ambientaliste, si dhe impaktet mbi trashëgiminë kulturore, mënjanimin e tyre, ose reduktimin e tyre në nivele të pranueshme si dhe veprimet e nevojshme për të zbatuar këto masa.

5. “Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës Shqiptare të Bashkive” nënkupton kryetarin e shoqatës së bashkive të Shqipërisë krijuar në 10 maj 2004.

6. “Manuali i menaxhimit financiar” nënkupton dokumentin e miratuar nga Përfituesi në mënyrë të pranueshme nga Shoqëria ku përcaktohen rregullat dhe rregulloret mbi menaxhimin financiar të projektit me gjithë ndryshimet e mundshme të here pas hershme me pëlqimin e Shoqërisë.

7. “Dispozita të përgjithshme” nënkupton kushtet e përgjithshme të Shoqërisë Ndërkombëtare të Zhvillimit mbi Kreditë dhe grantet” e datës 1 korrik 2005.

8. “Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme” ose “ZRPP” nënkupton Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme të Përfituesit.

9. Shpenzime operacionale shtesë” nënkupton shpenzime të nevojshme dhe të arsyeshme shtesë, të aprovuara nga Shoqëria mbi bazën buxheteve vjetore të pranueshme nga ana e saj, të kryera nga Ministria e Punëve Publike, ZRPP, Ministria e Brendshme për llogari të menaxhimit dhe

monitorimit të Projektit përfshirë shpenzimet e komunikimit, shpenzimet e korrierit dhe postës, shpenzimet e përkthimit me gojë dhe shkrim, detyrimet bankare, shpenzimet e udhëtimeve brenda vendit, dhe shpenzime të tjera të përgjithshme të lidhura drejtpërdrejt me implementimin e veprimtarive të projektit siç mund të bihet dakord Shoqërinë, por duke përjashtuar rrogat ose honoraret e zyrtarëve dhe të nëpunësve të Përfituesit përfshirë Ministrinë e Punëve Publike, ZRPP, dhe Ministrinë e Brendshme.

10. “Granti i bashkëfinancimit Japonez” nënkupton një shumë prej një milion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë dollarë që do të kontraktohen ndërmjet Përfituesit dhe Shoqërisë, e cila vepron si administratore e Qeverisë së Japonisë, për të ndihmuar në financimin e projektit.

11. “Marrëveshja e grantit të bashkëfinancimit Japonez” nënkupton marrëveshjen që do të lidhet ndërmjet Përfituesit dhe Shoqërisë si administratore e fondeve të siguruar nga Qeveria e Japonisë për grantin e bashkëfinancimit Japonez.

12. “Ministria e Financave” ose “MeF” nënkupton Ministrinë e Financave të Përfituesit dhe përfshinë çdo pasues të saj.

13. “Ministria e Brendshme” ose “MeB” Ministrinë e Brendshme të Përfituesit dhe përfshinë çdo pasues të saj.

14. “Ministria e Drejtësisë” nënkupton Ministrinë e Drejtësisë të Përfituesit dhe përfshinë çdo pasues të saj.

15. “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” ose “MPPTT” nënkupton Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Përfituesit dhe çdo pasues të saj.

16. “Bashkitë pjesëmarrëse” nënkuptojnë bashkitë e zgjedhura për të përfituar grante të vogla sipas pjesës C1 të projektit në vijim të kriterëve të pranimit të përcaktuar në manualin operacional të projektit (të përcaktuar më poshtë).

17. “Departamenti i planifikimit dhe monitorimit” nënkupton departamentin përgjegjës për planifikimin dhe monitorimin në ZRPP.

18. “Udhëzimet e prokurimit” nënkuptojnë “Udhëzime mbi prokurimin sipas huave të IBRD dhe Kredive të Shoqërisë Ndërkombëtare të Zhvillimit” botuar nga Banka në maj 2004.

19. “Plani prokurimit” nënkupton planin e prokurimit të Përfituesit mbi projektin të datës 14 dhjetor 2006 dhe referuar në paragrafin 1.16 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafit 1.24 të udhëzimeve të këshilluese të ndryshuara here pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve në fjalë.

20. “Manuali operacional i projektit” nënkupton dokumentin e miratuar nga Përfituesi në mënyrë të pranueshme nga ana e Shoqërisë ku përcaktohen rregullt dhe rregulloret e implementimit të projektit përfshirë kriteret e pranimit për grantet e vogla të bashkive pjesëmarrëse me gjithë ndryshimet e mundshme të herë pas hershme me pëlqimin e Shoqërisë.

21. “Komiteti drejtues i projektit” nënkupton komitetin përgjegjës të kordinimit të aktiviteteve të projektit dhe eniteteve kryesuar nga Ministri i Drejtësisë së Përfituesit ose një person i emëruar prej tij dhe të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, MeB, MPPTT, ZRPP dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës Shqiptare të Bashkive.

22. “Ligji i prokurimit publik të Shqipërisë” nënkupton ligjin nr.7971 të Përfituesit të datës 26 korrik 1995 ndryshuar për here të fundit nëpërmjet amendamentit nr.9372 të datës 14 prill 2005.

23. “Struktura e politikës së risistemimit” nënkupton dokumentin e përgatitur nga Përfituesi dhe miratuar më 1 shtator 2006 në mënyrë të pranueshme nga Shoqëria ku përcaktohen procedurat, aktet, politikat e vlerësimit, lehtësirat, monitorimi i çështjeve të mundshme të risistemimit që rezultojnë nga aktivitetet e kryera sipas projektit, si dhe specifikimi i rrethanave kur emërtimi i tokës nuk mund të mbështetet nga ky projekt me gjithë ndryshimet e mundshme të herë pas hershme me pëlqimin e Shoqërisë.

24. “Grantet e vogla” nënkuptojnë grantet e siguruar bashkive pjesëmarrëse sipas ndarjes C.1 të projektit për tu investuar në vijim të procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në manualin

operacional të projektit.

25. “Granti i bashkëfinancimit Suedez” nënkupton shumën e pesë milion dollarëve (\$ 5 milion) për t’u kontraktuar ndërmjet Përfituesit dhe Shoqërisë, e cila vepron si administratore e Qeverisë së Suedisë, për të financuar projektin.

26. “Marrëveshja e grantit të bashkëfinancimit Suedez” nënkupton marrëveshjen që do të lidhet ndërmjet Përfituesit dhe Shoqërisë, si administratore e fondeve të siguruara nga Qeveria e Suedisë për grantin e bashkëfinancimit Suedez.

27. “Shërbime teknike” nënkuptojnë koston e shpenzimeve të regjistrimit të parë, shkëmbimin dhe përmirësimin e të dhënave, dhe shërbime të ngjashme të rëna dakord midis Përfituesit dhe Shoqërisë.

28. “Kualifikimi” nënkupton aktivitete kualifikuese (përveç shërbimeve të konsulentëve) për t’u realizuar gjatë Projektit sipas aprovimit nga ana e Shoqërisë mbi bazën e kualifikimit vjetor dhe planeve të udhëtimeve të studimit të pranueshme nga Shoqëria përfshirë udhëtime të arsyeshme dhe të nevojshme brenda dhe jashtë shtetit, shpenzimet e vizave si pasojë e pjesëmarrjes në *workshope* dhe udhëtime studimi si dhe akomodim, shpenzime ditore, dieta ditore brenda dhe jashtë vendit, tarifa regjistrimi, pagesat për shkollim dhe pajisje, shpenzime të vogla organizative (përfshirë shpenzime për materiale kinkalerie, fotokopje, dhe materiale për kualifikim), shpenzimet e përkthimit me gojë dhe shkrim, shpenzimet e qerasë, dhe shpenzime të tjera që lidhen direkt me *workshopin* kualifikues dhe udhëtimin për qëllime studimi të rënë dakord me Shoqërinë.

29. “Departamenti i planifikimit urban” nënkupton departamentin për planifikimin urban në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468**  
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) .....	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

### **Botime të reja**

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 23.5.2007  
 Doli nga shtypi më 25.5.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”  
 Tiranë, 2007

Çmimi 56 lekë